



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT

RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT | 2015

RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT 2015

Për informata të mëtejshme, ju lutem kontaktoni:

Qëndrsa Mulaj
qendresa.mulaj@oagks.org
+381 (0) 38 60 60 04 10 12

Zyra Kombëtare e Auditimit
Rr. "Musine Kokalari", nr. 87
10 000 Prishtinë, Kosovë

Prishtinë, gusht 2016



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT

RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, Gusht 2016

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE	3
FJALA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM	4
Përmbledhje e Përgjithshme	6
Hyrje.....	8
1 Raporti Vjetor Financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës	10
2 Adresimi i Rekomandimeve të dhëna për PVF e vitit 2014	26
3 Qeverisja e Mirë.....	31
4 Prokurimi	40
5 Fushat me rëndësi të veçantë – performanca.....	45
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	51
Shtojca II: Opinionet e auditimit dhe rekomandimet kryesore.....	53
Shtojca III: Rekomandimet e RVA-së të vitit 2014.....	75

LISTA E SHKURTESAVE

AB	Auditim i brendshëm	MAShT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
AK	Autoritet Kontraktues	MF	Ministria e Financave
AKEE	Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë	MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit	MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
ANP-AJ	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës - Adem Jashari	MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
AP	Auditori i Përgjithshëm	NL	Niveli Lokal
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit	NQ	Niveli Qendror
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës	NSh	Ndërmarrje Shoqërore
BB	Banka Botërore	NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
BD	Bordi i Drejtorëve	NjMPAQ	Njësia për Monitorimin dhe Përdorimin e Automjeteve Qeveritare
BPV	Bruto Produkti Vendor	OB	Organizatë Buxhetore
BRK	Buxheti i Republikës së Kosovës	OE	Operatori Ekonomik
BSNKSP	Bordi për Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik	OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit	PAK	Personat me Aftësi të Kufizuar
DK	Dogana e Kosovës	PAKF	Personat me Aftësi të Kufizuar Fizike
DQH	Departamenti Qendror Harmonizues	PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
EE	Eficienca e Energjisë	PVF/BK	Pasqyrat Vjetore Financiare të Buxhetit të Kosovës
FMN	Fondit Monetar Ndërkombëtar	QK	Qeveria e Kosovës
IP	Institucionet e Pavarura	QMF	Qendra e Mjekësisë Familjare
INF	Institucionet Financiare Ndërkombëtare	RVA	Raporti Vjetor i Auditimit
KA	Komiteti i Auditimit	SIMFK	Sistemi i Informative i Menaxhimit Financiare të Kosovës
KBF	Komisioni për Buxhet dhe Financa	SMIBNJ	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Burimet Njerëzore
KBFP	Kontrolli i brendshëm i financave publike	SMTGKDB	Spektori për Mbikëqyrje të Transistit, Garancitë dhe kontabilitetit Doganore/Borxhit
KK	Kuvendi i Kosovës	SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
KKPAK	Këshilli Kombëtar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar	SNKSP	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
KMFP	Komisioni i mbikëqyrjes së financave publike	SNPPAB	Standardet Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale të Auditimit të Brendshëm
KMRV	Komisioni për Monitorim Raportim dhe Vlerësim	TP	Treguesit e Performancës
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	UA	Udhëzim Administrativ
LMFPP	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit	ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
LPP	Ligji për Prokurimin Publik	ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
LSHC	Ligji për shërbimin civil		

FJALA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM



Të nderuar anëtarë të Kuvendit,

Kam kënaqësinë që për herë të parë si institucion suprem i auditimit në kapacitetin kushtetues e ligjor që ka dhënë Kuvendi i Republikës së Kosovës t'ju dorëzoj Raportin Vjetor të Auditimit për vitin fiskal 2015.

Raportit Vjetor Financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 i është dhënë Opinion i Kualifikuar me Theksim të Çështjes për shkak të mos konsolidimit të pasqyrave individuale financiare dhe mos shpalosjes adekuate të informatave sa i përket shënimeve shpjeguese.

Përkundër kësaj, ka disa zhvillime të rëndësishme pozitive që janë evidentuar, duke përfshirë rritjen e realizimit të hyrave nga tatimet, financimi nga huamarrjet e brendshme si dhe performanca e mirë buxhetore në realizimin e pagesave. Gjithashtu kufiri i deficitit buxhetor është në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

Për të përfunduar këtë Raport, ne paraprakisht kemi audituar dhe publikuar 90 raporte të rregullsisë dhe 8 auditimeve të performancës që kanë të bëjnë me efektivitetin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve publike si dhe kemi përgaditur dhe publikuar edhe Raportin e Performancës Financiare të Institucioneve të Vetëqeverisjes Lokale.

Në bazë të rezultateve nga puna audituese, na është mundur që të japim rekomandime për të promovuar qeverisjen e mirë dhe të përmirësojmë menaxhimin financiar.

Dëshiroj të bëj thirrje për nivel më të lartë të vëmendjes në fazën e planifikimit, që do t'u lejonte institucioneve të kryejnë veprimtarinë në përputhje me nevojat e tyre dhe të raportojnë në mënyrë të vërtetë dhe të drejtë.

Entitetet publike duhet të veprojnë në kuadër të ligjit dhe të përmbushin obligimet e tyre ligjore dhe përdoruesit e fondeve publike duhet të jenë plotësisht të përgjegjshëm në menaxhimin e këtyre fondeve.

Mbështetja jonë konstruktive për institucionet e audituara siguron veprime të hershme për të adresuar dobësitë e identikuara dhe zhvillim të mëtutjeshëm të qeverisjes së mirë.

Ne synojmë të punojmë ngushtë me Kuvendin dhe Qeverinë për t'i zhvilluar më tej reformat aktuale në ndërtimin e qeverisjes së mirë dhe sistemeve më të mira për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Publikimi i raporteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit iu lejon qytetarëve të kërkojnë llogaridhënie nga ata të cilët janë përgjegjës të burimeve publike.

Rekomandimet e auditimit janë të fokusuara drejt përmirësimit të cilësisë në raportimin financiar të jashtëm, menaxhimit financiar të shtuar dhe përmirësime të shërbimeve publike.

Ne vazhdojmë t'i përmbahemi fuqimisht parimeve themelore për auditim cilësor dhe plotësisht të paanshëm.

Në fund, më lejoni të shpreh mirënjohjen për bashkpunimin e mirë për të gjitha institucionet që kanë qenë subjekt i auditimit, me theks të veçantë të Ministrisë së Financave si dhe Komisionit për Mbikqyrje Financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, vlerësoj lartë angazhimin profesional të personelit të Zyrës Kombëtare të Auditimit që kanë punuar me përkushtim për të zhvilluar auditimet në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe auditimit dhe brenda afateve ligjore në fushën e auditimit.

Prishtinë, Gusht 2016



Besnik Osmani
Auditor i Përgjithshëm

Përmbledhje e Përgjithshme

Parathënie

Ky Raport Vjetor i Auditimit përmbledhë gjetjet kryesore nga puna e ndërmarrë nga Auditori I Përgjithshëm dhe Zyra Kombëtare e Auditimit përgjatë sezonës së auditimit 2015/16. Puna jonë përfshinë:

- Auditimin e rregullsisë – auditim i pasqyrave vjetore financiare dhe auditim i pajtueshmërisë me rregullat dhe ligjet përkatëse
- Auditimin e performancës – rishikimi i vlerës për para të arritur nga përdorimi i burimeve

Auditimet tona janë ndërmarrë në pajtueshmëri me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik (ISSAIs).

Qështje kyçe në këtë Raport Vjetor të Auditimit është Buxheti i Republikës së Kosovës për të cilin është raportuar vetëm në këtë dokument.

Konkluzionet e përgjithshme

Konkluzionet kyçe janë:

Përderisa në nivel të përgjithshëm ka çështje pozitive për të raportuar duke përfshirë edhe rritjen e të hyrave, opinionin për pasqyrat e konsoliduara është kualifikuar për shkak të keqklasifikimeve materiale dhe jokonsistencën përbrenda Raportit Vjetor Financiar të Buxhetit të Kosovës.



Kërkohen veprime për të adresuar arsyet e kualifikimeve dhe theksimit të çështjeve përbrenda BKKRaportit Vjetor Financiar të Buxhetit të Kosovës.
(Kapitulli 2).

Një nivel i pamjaftueshëm i implementimit të rekomandimeve të auditimit është duke rezultuar në dobësi të vazhdueshme në kontrollet e brendshme dhe në efikasitetin operacional në Organizatat Buxhetore.



Duhet të forcohet llogaridhënia për implementimin e rekomandimeve të auditimit nga Qeveria dhe nga Organizatat Buxhetore.
(Kapitulli 3).

Edhe pse korniza ligjore dhe strategjitë ekzistojnë për të mbështetur aranzhimet e qeverisjes së mirë tek organizatat Buxhetore, implementimi i tyre kërkon përmirësime të mëtutjeshme.



Përdorim më efektiv të pyetësorit të vetëvlerësimit, zgjerim i njësisë së auditimit të brendshëm dhe përmirësimi i vlerësimit të rreziqeve janë disa nga çështjet kyçe që kërkojnë zhvillim për të përmirësuar aranzhimet e qeverisjes në Organizatat Buxhetore.

(Kapitulli 4)

Përmirësimet në prokurim janë të ngadalshme si pasojë e implementimit të ngadalshëm të prokurimit të centralizuar dhe sistemit të e-prokurimit.



Një monitorim rigoroz i planit dinamik duhet të zbatohet për të siguruar që të mos ketë më vonesa në zhvillimin e prokurimit.

(Kapitulli 5)

Performanca e Organizatave Buxhetore është duke stagnuar si pasojë e mungesës së menaxhimit efektiv strategjik dhe operacional përcjellur nga një kornizë ligjore të përshtatshme.



Objektiva të qarta dhe rezultate të monitoruara më nga afër janë zhvillimet kyçe që kërkohen për të përmirësuar menaxhimin e performancës në sektorin publik të Kosovës.

(Kapitulli 6)

Hyrje

Përdoruesit e fondeve publike duhet të jenë plotësisht të përgjegjshëm në menaxhimin e këtyre fondeve. Përderisa përgjegjësia direkte bie mbi Ministrat dhe Zyrtarët Kryesor Administrativ, Kryetarët e Komunave, Drejtorët Ekzekutiv etj, në procesin e menaxhimit financiar janë të përfshirë edhe një numër akterësh si anëtarët e zgjedhur të Kuvendit dhe të Asambleve Komunale, organet qeverisëse, menaxherët dhe stafi i Organizatave Buxhetore. Auditimi i jashtëm në këtë proces mundëson mbylljen e zinxhirit llogaridhënës në mes të Parlamentit dhe të Qeverisë. .

Në sektorin Publik të Kosovës, auditimi i jashtëm kryhet nga ZKA si një Institucion Suprem i Auditimit (ISA). Qëllimi ynë kryesorë është që të ndihmojmë Kuvendin për të mbajtur Qeverinë dhe institucionet ekzekutive llogaridhënëse për mënyrën se si paratë publike përdoren dhe raportohen, duke ruajtur interesat e qytetarëve. Puna jonë ka për qëllim që të ndihmojë ata të cilët punojnë në shërbimet publike për të përmirësuar qeverisjen e mirë, performancën dhe ofrimin e shërbimeve. Mbështetja jonë konstruktive për institucionet e audituara siguron veprime të hershme për të adresuar dobësitë e identifikuara dhe zhvillim të mëtutjeshëm të qeverisjes së mirë.

Ne kemi mbështetur procesin e llogaridhënies duke kryer në sezonin e auditimit 2015/16:

- 90 auditime statutores të rregullsisë – një kombinim i Auditimeve Financiare (duke konfirmuar nëse informatat financiare të paraqitura në Pasqyrat Vjetore Financiare janë të sakta dhe në konsistencë me kornizën ligjore financiare) dhe Auditime të Pajtushmërisë (duke konfirmuar që procesi dhe transaksionet janë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret relevante); dhe
- 8 Auditime të Performancës – duke vërtetuar nëse institucionet, projektet dhe programet sigurojnë ekonominë, efikasitetin dhe /ose efektivitetin në përdorimin e burimeve.

Raportet tona përfshirë edhe Raportin Vjetor të Auditimit, promovojnë llogaridhënie ndërmjet Kuvendit, Qeverisë dhe institucioneve publike gjithashtu edhe në nivel institucional individual përmes shqyrtimit të tyre nga Kuvendi dhe Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike. Publikimi i raporteve tona iu lejon qytetarëve të kërkojnë llogaridhënie nga ata të cilët janë përgjegjës të burimeve publike.

Puna jonë është përmbledhur në këtë Raport Vjetor të Auditimit si më poshtë:

Kapitulli	Fokusi	Përmbajtja
1	Raporti Vjetor Financiar i Buxhetit të Kosovës	Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Raportin Vjetor Financiar që reflekton rezultatet e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore individuale. Të gjeturat relevante janë të theksuara së bashku me mekanizmat për të përmirësuar pajtueshmërinë me standardet e kontabilitetit.
2	Adresimi i rekomandimeve të dhëna në vitet paraprake	Rekomandimet e auditimit janë të fokusuara drejt përmirësimit të kualitetit në raportimin financiar të jashtëm, Menaxhimin Financiar të shtuar dhe përmirësimet në shërbimet publike. Vlerësimi i veprimeve të ndërmarra në rekomandimet e kaluara është një element i rëndësishëm i punës së ZKA dhe është raportuar këtu.
3	Qeverisja e mirë	Qeverisja efektive mbështet performancën organizative të mirë dhe ofron kualitet të mirë të kontrolleve të brendshme. Produkti i punës tonë në këtë fushë është përmbledhur këtu dhe ne kemi konsideruar iniciativat Qeveritare për të përkrahur qeverisjen.
4	Prokurimi	Proceset e prokurimit adresojnë nivele të rëndësishme të shpenzimeve publike dhe ne raportojmë këtu rezultatet e auditimeve të rregullsisë dhe performancës të fokusuara në këtë çështje.
5	Performanca në fusha specifike	Performanca e OB në sigurimin e ekonomisë, efikasitetit dhe shërbimeve efikase ka ndikim direkt në kualitetin e shërbimeve të ofruara për individët dhe bizneset pavarësisht burimeve të pamjaftueshme. Ne raportojmë në performancën e një numri të fushave në këtë kapitull.

Raporti gjithashtu ka tri shtojca. E para shpjegon opinionet e ndryshme të dhëna nga Auditori i Përgjithshëm në auditimet e rregullsisë. E dyta specifikon opinionet e dhëna dhe arsyet për to. Përveç kësaj janë përmbledhur edhe rekomandime të rëndësishme të auditimit të bëra për institucionet e audituara. E treta specifikon se si janë adresuar rekomandimet e dhëna në Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2014.

Raportet e auditimeve individuale mund të gjenden në webfaqen tonë <http://www.oag-rks.org/sq/Ballina>.

Raporti Vjetor i Auditimit për vitin 2014 iu është dërguar Kuvendit më 31 gusht 2015 dhe më tetor 2015 është prezentuar nga AP në detyrë në mbledhjen e Komisionit për Mbikqyrje të Financave Publike. Ne presim që procesi këtë vit të finalizohet para se propozimi i buxhetit të Qeverisë për vitin 2017 ti dërgohet Kuvendit.

1 Raporti Vjetor Financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës

Konkluzioni i Përgjithshëm

Raportit Vjetor Financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 i është dhënë Opinion i Kualifikuar me Theksim të çështjes për shkak të mos konsolidimit të pasqyrave individuale financiare dhe mos shpalosjes adekuatave të informatave sa i përket shënimeve shpjeguese.

Përkundër kësaj, ka disa zhvillime pozitive në raportimin financiar për vitin 2015, duke përfshirë rritjen e realizimit të të hyrave nga tatimet, financimi nga huamarrjet e brendshme si dhe performanca e mirë buxhetore në realizimin e pagesave. Gjithashtu kufiri i deficitit buxhetor është në pajtueshmëri me kërkesat ligjore (brenda 2% te BPV).

Megjithatë, ka hapësirë për përmirësimin e mëtutjeshëm në Raportimin Financiar nga Organizatat Buxhetore individuale, dhe në një numër të caktuar të fushave. Kjo kryesisht ka të bëjë me klasifikimin e mallrave dhe shërbimeve dhe subvencioneve si investime kapitale. Po ashtu cilësia e informatave lidhur me shpalosjet duhet të rritet për të qartësuar llogaritë e arkëtueshme në nivel shtetërorë, si dhe të forcohet procesi i identifikimit dhe i regjistrimit të pasurive kapitale në SIMFK.

Ministria e Financave respektivisht Thesari duhet të ketë një angazhim më pro aktiv në sigurimin e kualitetit të pasqyrave financiare të cilat kërkojnë standarde të larta të raportimit dhe një regjim transparent të llogaridhënies. Veç tjerash kjo duhet për shkak të aspiratave integruese në BE,.

Edhe me tutje kërkohet përmirësimi në menaxhimin financiarë të transaksioneve dhe llogarive. Përderisa kishte një rritje domethënëse të të hyrave e cila tregon një zhvillim pozitiv, rritja e vlerës së llogarive të arkëtueshme na paraqitet si një sfidë që duhet të adresohet në vitet në vijim. Ekzekutimi i buxhetit është përmirësuar në vitin 2015, por realizimi i projekteve apo investimeve kapitale të planifikuara duhet të përmirësohet, në mënyrë që të përfitojnë taksapaguesit dhe bizneset nga përmirësimet në infrastrukturë dhe projekte të tjera.

1.1 Hyrja dhe Qasja e auditimit

RVF/BRK-së përmbledh transaksionet në lidhje me të gjitha aktivitetet e Qeverisë me përjashtim të Aktiviteteve të Bankës Qendrore, Fondit të Trustit të Kosovës dhe Agjencisë Kosovare të Inteligjencës. Ministrisë së Financave (MF), ka qenë përgjegjëse që në emër të Qeverisë, të përgatit RVF/BRK-së për vitin 2015 jo më larg se me 31 Mars të vitit 2016 në formatin e kërkuar nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) dhe sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”.

Neni 47.1 i LMFPP-së përcakton se ZKA është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e RVF/BRK-së.

Auditimi ynë është fokusuar në: Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me ekzekutimin, pasqyrën e konsoliduar të pasurive në para të gatshme dhe bilancin e fondit dhe shënimet shpjeguese;

- Objektiva e auditimit ka qenë të vlerësojmë Nëse këto pasqyra financiare paraqesin, në të gjitha aspektet materiale, një pamje të drejtë dhe të vërtetë të gjendjes financiare për periudhën e auditimit; dhe
- Nëse janë ndërmarr masat e duhura nga Qeveria për implementimin e rekomandimeve të AP-së për vitin 2014 dhe vitet e mëhershme.

Ne gjithashtu kemi marrë në konsideratë deklaratën e bërë nga Ministri i Financave dhe Drejtori i Thesarit për RVF/BRK-së, me rastin e dorëzimit në Kuvend dhe tek AP.

Qasja jonë është bazuar në një kuptim të plotë të procesit nëpër të cilin RVF/BRK janë hartuar. Kjo na ka mundësuar që të zhvillojmë një strategji auditimi, e cila përqendrohet në adresimin e rreziqeve specifike. Ne gjithashtu kemi rishikuar pajtueshmërinë me kufirin e deficitit buxhetor, analizën e RVF/BRK-së si dhe pasqyrat financiare të organizatave buxhetore individuale duke përfshirë konsolidimin e llogarive.

1.2 Opinioni i Auditimit

Opinioni i Auditimit

Ne kemi audituar Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, i cili përfshinë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me realizimin, pasqyrën e konsoliduar në para të gatshme dhe bilancin e fondeve si dhe shënimet shpjeguese/shpalosjet të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin Baza për Opinion të Kualifikuar, Raporti Vjetor Financiar prezanton një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Baza për Opinion

Shpenzimet për mallra dhe shërbime si dhe subvencione dhe transfere në vlerë prej 25,307,551€ ishin keq klasifikuar si investime kapitale. Nga këto, 23,171,222€ ishin keqklasifikuar për shkak të buxhetimit jo të drejtë të shpenzimeve nga Ministria e Financave derisa 2,136,329€ janë keq klasifikuar nga vet OB si pasojë e gabimeve dhe aplikimit jo të drejtë të planit kontabël.

Të dhënat e rëndësishme të prezantuara në Pasqyrën e Konsoliduar të Krahasimit të Buxhetit me Realizimin janë materialisht të pasakta dhe nuk kanë konsistencë me pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme. Kjo ka ndodhur për shkak të mos aplikimit të krahasueshmërisë me rastin e konsolidimit të pasqyrave financiare nga MF/Thesari.

Shënimet shpjeguese janë jo complete. Përderisa kjo nuk ndikon në pjesët tjera të pasqyrave të konsoliduara, pasqyra e realizimit të buxhetit përmban gabimet e më poshtme;

- Tek rrjedha hyrëse e parasë së gatshme në LLVTH - buxheti fillestar për të hyrat tatimore është nënvlerësuar për 104,400,000€, buxheti final financim nga huamarrja ishte nënvlerësuar për 20,470,000€, si dhe realizimi i pranimeve nga donacionet, depozitat dhe kthimet e huas për ndërmarrje publike të nënvlerësuara për 17,025,000€; dhe
- Tek rrjedha dalëse e parasë së gatshme nga LLVTH - buxheti final për donacione është nënvlerësuar për 19,870,786€, pagesat nga donacionet janë nënvlerësuar për 12,941,000€, dhe kthimi i depozitave për 3,413,000€.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare të organizatave buxhetore në Kosovë, ZKA është i pavarur nga Qeveria e Kosovës/ Ministria e Financave dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Theksimi i çështjes

Ne gjithashtu tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se :

- Në një rast , gjatë vitit 2015 Komuna¹ ka identifikuar pasuri të cilat nuk ishin të evidentuara deri atëherë. Këto pasuri, ajo i kishte shpalosur në pasqyrat vjetore financiare të saj për 2015 dhe vlera e tyre arrin shumë prej 2,468,469,000€. Mirëpo të njëjtat pasuri, Ministria e Financave respektivisht Thesari nuk i kishte paraqitur në Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit të Kosovës me arsyetimin se këto pasuri nuk ishin regjistruar paraprakisht në SIMFK si kusht për raportimin e tyre. Derisa regjistrimi në SIMFK nuk ishte bërë për shkak të mungesës komunikimit dhe bashkëveprimit në mes të Komunës përkatëse dhe MF-së respektivisht Thesarit.
- Vlera totale e pasurive kapitale e prezantuar në RVF/BRK-së nuk mund të konfirmohet si e kompletuar për shkak të keq klasifikimit të investimeve kapitale , kjo është paraqitur tek pjesa e opinionit. Pasuria është e nënvlerësuar për 5,167,356€², si pasojë e dështimit në regjistrimin e plotë të tyre. Në³ katër komuna dhe në një institucion të pavarur pasuria kapitale nuk ishte e regjistruar në SIMFK, nuk ishte prezantuar në pasqyrat e tyre financiare dhe si pasojë nuk ishte paraqitur në RVF/BRK-së.
- Në RVF/BRK-së llogarit e arkëtueshme prej 693,861,428€ nuk janë të shpalosura. Prej tyre, 463,196,881€ i takojnë llogarive të arkëtueshme të ATK-së, 44,750,197€ i takojnë Doganës së Kosovës dhe 185,914,350€ nivelit Komunal.

¹ Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Prishtinës për vitin financiar 2015.

² MSH, ZKM, MBPZHR, KRPP, Kamenica, Parteshi

³ Zveçani, Zubin Potoku, Leposaviqi, Mamusha dhe KRPP

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të tilla të cilat menaxhimet i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keq deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri i Financave është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keq deklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keq deklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keq deklarim material kur ai ekziston. Keq deklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritët që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq deklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.3 Deklarata mbi kufirin e deficitit buxhetor

Ligji për MFPP nr. 03/L-048 (me plotësime dhe ndryshime), përfshinë një vlerësim të pajtueshmërisë për kufirin e deficitit buxhetor i cili nuk duhet të tejkalojë nivelin prej 2% të Bruto Produkti Vendor (BPV) të parashikuar në vlerë prej 5,879,000,000€.

Ne kemi vlerësuar proceset në kuadër të MF-së për të siguruar zbatimin e këtyre kërkesave nga ligji lidhur me kufijtë e deficitit buxhetor dhe kemi vlerësuar kufirin aktual në fund vitin 2015.

Ligji i buxhetit për vitin 2015 i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës është aprovuar me një deficit buxhetore prej 2% të BPV-së. Përderisa, deficitin aktual në fund të vitit 2015 ishte 1,3%.

Vlenë të theksohet se Qeveria me rastin e përgatitjes së Projekt Ligjit për Ndarjet Buxhetore për vitin 2015, kishte siguruar që deficitin i planifikuar të jetë brenda kufirit të lejuar me LMFP. Kjo ka qenë një prej rekomandimeve tona të vitit të kaluar.

1.4 Rreziku domethënës dhe çështje tjera kyçe të konsolidimit

Qasja jonë e auditimit ishte fokusuar në ato fusha ku kishte rrezik të keq deklarimit material të pasqyrave të konsoliduara si dhe në fushat kryesore të auditimit për ti identifikuar veprimet e nevojshme për adresimin e të gjeturave. Rreziku domethënës i identifikuar ka rezultuar me kualifikim të opinionit dhe theksim të çështjes.

Përveç rreziqeve domethënëse të prezantuara tek opinionin e auditimit, ne kemi identifikuar edhe një numër fushash të tjera, të cilat ne nuk konsiderojmë që paraqesin rrezik domethënës për keq deklarim material në pasqyrat financiare por janë çështje të cilat duhet të merren në konsideratë nga Qeveria:

- Krahasuar me vitin 2014, Ministria e Financave ka ndërmarr veprime konkrete për të siguruar regjistrimin e pagesave nga palët e treta në SIMFK. Përveq procedurave të shkruara për menaxhimin e granteve, Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit në tetor 2015, ka përgatitur një qarkore njoftimi për të gjitha OB-të përmes së cilës ka inicuar regjistrimin e të gjitha pagesave nga palët e treta në Sistem. Përkundër veprimeve të ndërmarra, pagesat nga palët e treta nuk janë regjistruar plotësisht dhe për pasojë as nuk janë raportuar në RVF/BRK-së. Në RVF/BRK-së janë raportuar 1,364,684€, ndërsa sipas auditimit kjo vlerë është 7,485,061€, Me një nënvlerësim prej 6,120,377€;

Tabela 1. Përmbledhje e çështjeve me ndikim në RVF/BRK-së si dhe çështje tjera të konsolidimit.

Modifikimi i opinionit			
Çështja	Shkaku	Ndikimi	Veprimi i nevojshëm
Keq klasifikimi i shpenzimeve . Shuma të konsiderueshme të ndarjeve buxhetore janë aprovuar në kategori ekonomike joadekuat dhe si të tilla janë përfshirë në tabelat buxhetore.	Përgatitja e buxhetit të Republikës së Kosovës nga MF pa një shqyrtim të plotë duke neglizhuar ndikimin e keq klasifikimit të buxhetit në raportim.	Klasifikimi i gabuar i shpenzimeve rezulton në nënvlerësimin respektivisht mbivlerësimin e shpenzimeve sipas kategorive e në veçanti të investimeve kapitale.	MF me rastin e përgatitjes së buxhetit për 2017 të siguroj ndarjen buxhetore nëpër kategoritë e duhura ekonomike.

Gabimet në pasqyrën e konsoliduar të buxhetit dhe realizimit	Mungesa e kontrolleve efektive në procesin e konsolidimit.	Prezantimi i pasaktë i pasqyrës së realizimit të buxhetit në Kuvend.	Para se RVF/BRK-së të dërgohen në Qeveri dhe Kuvend, MF duhet të sigurojë se është vendosur një proces efektiv i kontrolleve dhe i mbikqyrjes së procesit të konsolidimit.
Theksimi i çështjes			
Çështja	Shkaku	Ndikimi	Veprimi i nevojshëm
RVF/BRK-së nuk përfshijnë të gjitha pasuritë e regjistruara nga OB-të apo që janë pronësi të OB-ve por që nuk janë të regjistruara në SIMFK.	Procesi i konsolidimit të të dhënave është kryer vetëm pjesërisht.	Prezantimi jo i plotë dhe jo i saktë i pasurive në Kuvend do të ketë efekte në proceset e vendimmarrjes në lidhje me shpërndarjet buxhetore.	Ministria e Financave të adresoj dobësitë në menaxhimin e pasurive, me objektivin që të prezantojnë gjendjen e plot duke përfshirë edhe shënimet e kërkuara shpjeguese.
Llogarit e arkëtueshme nuk janë prezantuar në RVF/BRK-së.	Mungesa e një procesi efektiv të konsolidimit ka rezultuar me diferenca në prezentimin e gjendjes së këtyre llogarive.	Prezantimi jo i plotë dhe jo i saktë i llogarive të arkëtueshme në Kuvend do të ketë efekte në proceset e vendimmarrjes në lidhje me shpërndarjet buxhetore.	Ministria e Financave të adresoj dobësitë në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, me objektivin që të prezantojnë gjendjen e plotë duke përfshirë edhe shënimet e kërkuara shpjeguese.
Çështje tjera të rëndësishme të auditimit			
Çështja	Shkaku	Ndikimi	Veprimi i nevojshëm
Pagesat nga palët e treta të prezantuara në RVF/BRK-së janë nënvlerësuar për 6,120,377€.	OB ende nuk e aplikojnë plotësisht regjistrimin e pagesave nga palët e treta në SIMFK.	Prezantimi jo i plotë dhe jo i saktë i pagesave nga palët e treta në Kuvend do të ketë efekte në proceset e vendimmarrjes – potencialisht nga donatoret e jashtëm.	Ministria e Financave të mbajë trajnime dhe të jap udhëzime që të siguroj se pagesat nga palët e treta të regjistrohen në SIMFK.

1.5 Roli i Ministrisë së Financave / Thesarit në sigurimin e pasqyrave financiare të cilësisë së lartë

MF/Thesari rolin kryesor e ka në adaptimin dhe sigurimin e implementimit të standardeve relevante ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit të mbështetura në dispozitat, si dhe përditësimin e rregullave financiare. Çështjet e paraqitura në kapitullin 3.4 theksojnë nevojën për veprime pro aktive në disa fusha, duke përfshirë;

- Përditësimin e vëllimeve të Thesarit (të publikuara në vitin 2007) për të reflektuar zhvillimet si në SIMFK ashtu edhe në standardet e kontabiliteti si dhe në kërkesat Qeveritare të raportimit;
- Promovimi i pajtueshmërisë me standardet e kontabilitetit duke siguruar së të gjitha veprimet e ndërmarra janë në pajtueshmëri me këto standarde si dhe me praktikën më të mirë të kontabilitetit;
- Të ofroj trajnim të duhur vjetor për përgatitjen e PVF (i cili nuk ishte ofruar në vitin 2015) dhe
- Të ndërmarr veprime për përgatitjen dhe aplikimin e rregulloreve financiare për menaxhimin e subvencioneve dhe llogarive të arkëtueshme, që të arrihet një proces me efektivë dhe transparent për menaxhimin e tyre.

Përmirësimet në këto fusha kërkojnë ndryshime të mëdha në mënyrën se si Ministria e Financave dhe Thesari veprojnë/i mbështesin OB-të. Veprimet kyçe që kërkojnë do të përfshijnë krijimin e një plani kontabël të azhurnuar me instruksione dhe shpjegime shtesë për të mundur regjistrimin e shpenzimeve në kode adekuate ekonomike .

1.6 Analiza e Raportit Vjetor Financiar të Buxhetit të Kosovës

1.6.1 Analiza e pasqyrave themelore

Buxheti final për pranimet ishte 1,750,681,000€ përderisa realizimi ishte 1,690,349,000€ apo 97% e buxhetit. Në raport me vitin 2014 pranimet ishin rritur për 16.6%. Rritja ishte rezultat i inkasimit më të lartë të tatimeve, financimit nga huamarrja, dhe financimit të njëhershëm i AKP-së dhe i mbledhjes së të hyrave vetanake.

Tabela 2. Buxheti dhe realizimi i pranimeve në raport me pagesat sipas RVF (000 në €).

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	Realizimi 2015 ⁴	Realizimi 2014	Realizimi 2013
Pranimet	1,750,681	1,750,681	1,690,349	1,448,957	1,428,704
Pagesat	1,727,138	1,712,802	1,597,983	1,498,400	1,500,176

Përformanca e mirë buxhetore ishte rezultat i ndryshimeve të politikave fiskale, aplikimi i rritjes së normës së TVSH-së dhe të akcizës për disa produkte të caktuara, si dhe përforsimit të kontroleve në menaxhimin e të hyrave. Vlen, të cekët që, Dogana dhe ATK-ja kanë vendosur mekanizma adekuat dhe kanë zhvilluar kontrole efektive në menaxhimin e të hyrave. Në planet e tyre strategjike dhe operative, i kanë dhënë

⁴ Në këtë kolonë nuk janë të përfshira pranimet dhe pagesat nga donatorët si dhe pranimet dhe kthimet e depozitave

rëndësi të veçantë luftimit të informalitetit dhe evazionit fiskal. Po ashtu, kanë hartuar planet e veprimit për luftimin e këtyre dukurive.

Tabela 3. Buxheti dhe realizimi i pranimeve në raport me pagesat sipas RVF (000 në €)

Pranimet	Buxheti final	Realizimi 2015	Realizimi 2014	Realizimi 2013
Tatimet	1,246,800	1,248,936	1,141,157	1,104,843
Të hyrat vetanake	114,240	107,203	97,446	94.953
Financim nga huamarrja	206,530	166,719	113,836	83,835
Të tjera	183,111	167,490	96,519	145,073
Totali	1,750,681	1,690,349	1,448,957	1,428,704

Të hyrat tatimore të realizuara për vitin 2015 ishin 1,248,936,000€, me një tejkalim të planit për 2,136,000€. Prej tyre, 944,930,000€ ishin të realizuara nga Dogana, dhe 304,007,000€ nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK). Në raport me vitin 2014, realizimi i të hyrave në Doganë është rritur për afro 9%, ndërsa në ATK për 11.5%.

Ndërtimi i procesit buxhetor jo i bazuar në parashikime të qëndrueshme dhe reale të hyrave - Ligji nr. 05/L -001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, buxheti fillestar për të hyrat nga tatimet për të dy agjencitë (DK dhe ATK) ishte 1,348,200,000€, përderisa me rishikim të buxhetit plani i të hyrave është shkurtuar për 104,400,000€. Prej tyre, 87,500,000€⁵ i takojnë shkurtimeve në ATK, dhe 16,900,000 Doganës. Shkurtimi buxhetor ka pasur për pasoj edhe shkurtimin e shpenzimeve operative prej 49,000,000€.

Mos realizimi i projekteve të Financuara nga Huamarrja - Në fund të vitit 2015, financimi nga huamarrjet (borxhi i përgjithshëm) ishte 748,950,000€⁶. Prej tyre, 377,780,000€ nga huamarrja e brendshme dhe 371,170,000€ nga huamarrja e jashtme.

Huamarrja e brendshme – Financimi nga huamarrja e brendshme ishte planifikuar në vlerë prej 120,000,000€ derisa ishin realizuar 121,262,000€. Qëllimi i huamarrjes së brendshme ishte financimi i deficitit buxhetor, si dhe rritja e bilancit bankar⁷. Gjatë vitit 2015, bilanci bankar është rritur për 93,037,000€ duke arritur në 256,539,000€.

Huamarrja e jashtme – Qëllimi i huamarrjes së jashtme ishte financimi i infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore, shëndetësisë, energjisë, si dhe trajtimit të ujërave. Vlera totale e planifikuar ishte 107,000,000€, derisa ishin realizuar 45,000,000€ ose 42% të vlerës së planifikuar. Nga vlera totale e pranuar prej 45,000,000€ ishin shpenzuar 6,750,000€ ose 15%.

Marrja e huave nën nivelin e planifikuar si dhe realizimi i ulët i huave të pranuar ishte pasojë e ngecjeve në implementimin e marrëveshjes nga palët e ndërlidhura për projekte të caktuara.

⁵ Të hyrat tatimore nga ATK-ja ishin parashikuar në vlerë prej 388,300,000€ përderisa me rishikim të buxhetit projekcioni ishte 300,800,000€, kemi një shkurtim prej 87,500,000€ apo 22% e planit fillestar.

⁶ Nga financimet nga huamarrjet në total ishte prej 748,950,000€ , 166,719,000 € ishte vlera e pranimet të financimeve nga huamarrjet gjatë vitit 2015 (121,262,000€ huamarrja e brendshme dhe 45,458,000€ huamarrja e jashtme).

⁷ Rritja e bilancit bankar është kërkesë e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) e cila deri në fund të vitit 2016 planifikohet të jetë e barabartë me 4.5% të vlerës së BPV-së.

Qeveria kishte planifikuar që kah fundi i vitit 2015 të merrë një hua nga FMN prej 35,000,000€. Marrja e huasë ishte kushtëzuar me aprovimin e buxhetit nga Kuvendi për vitin 2016 me kohë (deri më 31 dhjetor 2015). Mirëpo për shkak të zhvillimeve politike në Kuvend, buxheti për 2016 është aprovuar në fillim të vitit 2016. Kjo ka ndikuar që huaja të mirret në fillim të vitit 2016 dhe jo siq ka qenë e planifikuar në 2015. Projektet për financim nga huamarrja e jashtme por të parealizuara me kohë kanë të bëjnë me:

- ndërtimin e rrugës Prishtinë – Mitrovicë dhe rehabilitimin e linjës së hekurudhës Hani i Melezit – Leshka në vlerë prej 30,100,000€; dhe
- financimin e projekteve në shëndetësi në vlerë prej 5,050,000€.

Projekti “Shëndetësia Kosovare” në vlerë prej 2,450,000€ ishte planifikuar të financohet nga Banka Botërore (BB). Sidoqoftë, implementimi i këtij projekti ka filluar në muajin shtator 2015 dhe deri në fund të vitit ishin realizuar 57,000€. Arsyet për implementim të ulët ishin: zhvillimet politike gjashtë mujore gjatë vitit 2014; pezullimi i aktiviteteve të projektit nga Ministria e Shëndetësisë, si dhe vonesat në zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Ndërsa pjesa tjetër prej 2,600,000€ ishte planifikuar nga Qeveria e Republikës së Austrisë për projektin e kardiokirurgjisë. Implementimi i këtij projekti kishte ngecur për shkak të procedurave për ratifikimin e projektit nga Kuvendi. .

Analiza e Pagesave në para të gatshme

Tabela 4. Buxheti final dhe realizimi për 2015 (000 në €)

PËRSHKRIMI	Buxheti final	Realizimi 2015	% e realizimit	Realizimi 2014	Realizimi 2013
Pagat dhe Mëditjet	532,682	524,996	98	485,247	417,093
Mallrat dhe Shërbimet	196,717	181,292	92	183,658	193,857
Shpenzimet Komunale	25,564	24,164	94	22,099	21,662
Subvencionet dhe Transferet	431,914	418,084	96	361,160	312,916
Shpenzimet Kapitale	480,469	403,851	84	411,360	529,176
Rezervat	843	-	-	-	-
Nën totali	1,668,189	1,552,387	93	1,463,524	1,474,704
Pagesa e borxhit	43,895	44,878	102	34,160	25,472
Anëtarësimi në INF	717	717	100	717	0,00
Nën totali	44,612	45,595	102	34,877	25,472
GJITHSEJ	1,712,801	1,597,982	93	1,498,401	1,500,176

Çështjet kryesore të dalura nga analizat tona janë si në vijim:

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit - Më gjithë avancimet e bëra nga Niveli Qendror (NQ)⁸ dhe Niveli Lokal (NL)⁹ për të përmirësuar menaxhimin e financave publike dhe sistemin e kontroleve, edhe më tutje ekziston një numër i konsiderueshëm i mangësive në proceset buxhetore. Një pjesë e tyre janë paraqitur edhe në raportet e viteve të kaluara.

Pagat dhe Mëditjet – Niveli i shpenzimeve ishte 98% e buxhetit.

Menaxhimi i personelit në nivelin OB-ve ishte përcjellë më parregullsi nga më të ndryshmet si; mbulimi i pozitave me ushtrues detyre, lidhja e kontratave për shërbime të veçanta pa procedura të rekrutimit, gabime në kalkulimin e kompensimeve për punë jashtë orarit, si dhe mospërputhje e titujve të punës në mes akt emërimeve dhe listës së pagave. Në raste të caktuara, si rrjedhojë e tejkalimeve të buxhetit për paga një pjesë e shpenzimeve ishte mbuluar nga mallrat dhe shërbimet.

Sfidat me të cilat vazhdon të ballafaqohet niveli lokal është mungesa e përfshirjes në lista të pagave të punonjësve zëvendësues të arsimit. Në pamundësi të futjes në lista të pagave, niveli lokal është ballafaquar me padi dhe pretendime nga punëtorët e angazhuar jashtë listës së pagave. Për pasoj, ka pasur pagesa të kryera direkt nga thesari apo edhe përmes vendimeve gjyqësore.

Rritja e shpenzimeve për paga në raport me vitin 2014 në vlerë prej 40,000,000€ vjen nga vendimet e Qeverisë për pagesën e përvojës së punës për punëtorët e sektorit publik dhe për shkak të rritjes së numrit të punësuarve në nivelin qendror.

Mallra dhe Shërbime-Niveli i shpenzimeve ishte 92% e buxhetit

Në këtë kategori ne kemi identifikuar, përveq tjerash, parregullsi në menaxhimin e avanseve për udhëtime zyrtare, tejkalimet e shpenzimeve të telefonisë mobile, si dhe ishin të angazhuar gjithsej 1,029 punëtorë me kontrata për shërbime të veçanta me kosto totale 1,659,843€. Ndërsa një pjesë e shpenzimeve për mallra dhe shërbime janë klasifikuar si investime kapitale, kjo është paraqitur në nënkapitullin e opinionit.

Subvencionet dhe Transferet -Niveli i shpenzimeve ishte 96% e buxhetit

Menaxhimi i subvencioneve si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal mbetet sfidë. Praktika aktuale e vlerësimit, monitorimit dhe raportimit të subvencioneve nuk ofron siguri të mjaftueshme se ato shfrytëzohen për qëllimet e dedikuara dhe nëse janë arritur rezultatet e pritura. Sipas të dhënave të paraqitura në Raportin Vjetor Financiar të Qeverisë, rritja e shpenzimeve në raport me vitin 2014 prej 57,000,000€ kryesisht vjen nga rritja e pagesave për pensionet bazë kontribut dhënës dhe rritja e pagesave për sektorin e bujqësisë.

Investimet Kapitale- Niveli i shpenzimeve ishte 84% e buxhetit.

Rreth 35% e totalit të pagesave për kapitalet janë realizuar në muajt nëntor dhe dhjetor. Më tutje, pas mbylljes së afatit për pagesa në fund të muajit dhjetor, me vendim të Ministrit të Financave janë ekzekutuar pagesa prej 37,533,272€ apo 9% e totalit të pagesave për investime kapitale.

⁸ Niveli Qendror përfshinë Institucionet Qendrore dhe Institucionet e pavarura.

⁹ Niveli Lokal përfshinë të gjitha komunat e Republikës së Kosovës

Volumi i lartë i pagesave në fund të vitit rrit rrezikun për realizim të pagesave të parregullta dhe për blerje të pa nevojshme. Niveli i ulët i realizimit të buxhetit ishte ndikuar nga mungesa e projekteve konkrete për të cilat ishte alokuar buxheti, vonesat në procedurat prokurimit si dhe proceset e mangëta të monitorimit të projekteve.

1.6.2 Analiza e shpalosjeve / shënimeve

Pasuritë

Kontrollet vazhdojnë të jenë jo efektive në menaxhimin e pasurisë (kapitale dhe jo kapitale). Kjo është trajtuar si theksim i çështjes në seksionin e opinionit në këtë kapitull.

Më tutje, mangësi kishte edhe në numrimin fizik dhe vlerësimin e pasurisë. Raportet e inventarizimit të pasurisë në disa raste nuk ishin finalizuar. Mangësitë janë hasur edhe në kategorizimin e pasurisë, zhvlerësimin, tjetërsimin dhe klasifikimin jo të drejtë të investimeve në vijim.

Sa i përket automjeteve qeveritare, një numër i konsiderueshëm i tyre shfrytëzohen nga stafi politik dhe menaxherial të cilët në shumicën e rasteve nuk mbajnë shënime rreth përdorimit të tyre. Në shumë raste automjetet përdoren pas orarit të rregullt të punës, nuk ka raportim për sasinë e karburanteve të shpenzuara dhe numrin e kilometrave të kaluara.

Mangësi janë identifikuar edhe me rastin e servisimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, dhe mos regjistrimi i tyre në regjistrin e pasurisë.

Në Ministrinë së Administratës Publike - vepron Njësia për Monitorimin dhe Përdorimin e Automjeteve Qeveritare (NjMPAQ) e cila raporton rreth shfrytëzimit të automjeteve zyrtare. Raportimi i OB-ve në këtë njësi vazhdon të jetë shumë i mangët. Në vitin 2015 vetëm tri OB (Ministria e Bujqësisë, Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Kulturës) kanë raportuar në këtë njësi.

Obligimet e papaguara

Obligimet e papaguara të OB-ve në fund të vitit 2015 janë 207,262,005€, krahasuar me vitin 2014 obligimet janë rritur për 41,874,093€. Rritja e obligimeve është më e theksuar tek organizatat e nivelit qendror.

Tabela 5 Obligimet e papaguara (000€)

Përshkrimi	2015	2014	2013
Niveli Qendror	191,816	148,199	29,940
Niveli Lokal	15,445	17,188	23,685
Gjithsej	207,262	165,387	53,626

Shumica e obligimeve në nivelin qendror lidhen me:

- 145,571,431€ i takojnë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Obligimet kanë të bëjnë me procesin e shpronësimit. Pagesa e obligimeve nga buxhetet e viteve vijuese mund të rezultoj me shkurtime buxhetore dhe reduktimin e numrit të projekteve të reja.
- Ministria e Infrastrukturës - obligimet e pa paguara kanë të bëjnë me projektin “Autostrada Prishtinë – Shkup” në vlerë prej 13,000,000€, dhe pjesa tjetër e kësaj është nga ndërtimi i rrugëve të tjera si dhe nga mirëmbajtja dhe riparimi i tyre.
- Ministria e Bujqësisë - obligimet e papaguara prej 9,171,080€ në Subvencione dhe Transfere. Prej tyre, 4,000,000€ janë obligime të miratuara në bazë të Programit për Zhvillimin Rural të Bujqësisë, ku ekzekutimi i pagesave zgjat mbi dy vite, dhe llogariten si obligime ligjore. Pjesa tjetër ka të bëjë me obligimet për subvencione të parapara të paguhen në vitin 2015.

Obligimet e tjera nga ato të shpronësimit janë krijuar si rezultat i hyrjes në obligime kontraktuale në mungesë të mjeteve të mjaftueshme për financimin e tyre si dhe pranimit dhe procesimit të faturave më vonës¹⁰. Për më tepër, cilësia e raportimit ishte e dobët.

Në raste të caktuara, OB-të nuk i kishin raportuar obligimet e tyre rregullisht në MF e në disa raste tjera obligimet e raportuara nuk ishin të plota.

Mos pagesa e obligimeve nga OB-të me kohë ka bërë që një pjesë e konsiderueshme e tyre të paguhen nga Thesari dhe nga Gjykatat (shih nënkapitullin më poshtë pagesat drejtpërdrejtë nga Thesari dhe Gjykatat). Vonesat në pagesat e obligimeve shkaktojnë efekte negative në menaxhimin e buxhetit duke ngarkuar buxhetet në vitet në vijim, dhe pamundësojnë arritjen e objektivave të planifikuara.

Mos shpalosja e llogarive të arkëtueshme në RVF

Niveli Qendror - Rritje më e theksuar e llogarive të arkëtueshme vërehet tek ATK të cilat krahasuar me 2014 ishin rritur për 185,373,391€¹¹. Sipas ATK-së njëri nga faktorët kryesor të rritjes ishte shpalosja e të arkëtueshmeve pasive në PVF 2015, të cilat nuk ishin shpalosur në vitet e mëhershme. Niveli i llogarive të arkëtueshme është rreth 60% të hyrave të realizuara nga ATK-ja për vitin 2015.

Rritje të llogarive të arkëtueshme kishte pasur edhe në Doganën e Kosovës të cilat krahasuar me 2014 ishin 10,132,409€. Sipas Doganës¹² kjo rritje vjen si pasojë e identifikimit të llogarive të arkëtueshme që datojnë nga vitet e mëparshme. Këto llogari nuk figuronin në regjistrat e brendshme të doganës dhe nuk ishin prezentuar në raportet financiare të viteve të kaluara. Mirëpo pas identifikimit të tyre, ato janë regjistruar në sistem dhe raportuar në pasqyrat financiare të vitit 2015.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike deri në vitin 2008, ATK dhe Dogana kanë përgatitur dhe dërguar në MF listat për faljen e borxheve.

¹⁰ Kjo është nxjerre nga analiza e obligimeve në raport me buxhetin në gjashtë OB-të të cilat kanë obligimet më të larta.

¹¹ Llogaritë e arkëtueshme në fund të vitit 2015 ishin 463,196,881€, të cilat në raport me vitin 2014 ishin rritë për 185,373,391€ (në fund të vitit 2014 të arkëtueshme ishin 277,823,490€).

¹² Sektori për menaxhimin e borxheve në Doganë

Borxhet ndaj ATK-së për falje arrin vlerën prej 298,277,872€. Prej tyre , deri në fund të vitit 2015 janë falur borxhe vetëm 16,943,796€.

Ndërsa, borxhet ndaj DK-së për falje arrin vlerën prej 5,641,168€. Prej tyre deri në fund të 2015 nuk kishte ndonjë rast të faljes për shkak se nga bizneset dhe personat fizik nuk kishin arritur marrëveshje për falje sipas Ligjit për falje të borxheve.

Niveli Lokal- Llogaritë e arkëtueshme në nivelin lokal në 2015 ishin 185,914,350€. Krahasuar me vitin 2014 ato ishin rritur për 2,409,678€.

Mungesa e informatave të plota rreth llogarive të arkëtueshme mund të rezultojë me projeksione të gabuara buxhetore dhe reduktim të projekteve të reja. Mungesa e veprimeve të mjaftueshme për inkasimin e borxheve publike nuk i inkurajon debitorët tjerë që ti paguajnë obligimet e tyre me kohë. Vjetërsia e borxheve e vështirëson mbledhjen e tyre.

Pagesat e kryera drejtpërdrejt nga Thesari dhe me Vendime të Gjykatave

Për vitin 2015, Thesari ka ekzekutuar pagesa sipas nenit 39.2 dhe 40 në vlerë prej 11,499,582€¹³.

Tabela 6: Pagesat me vendim të Gjykatave

Pagesat me vendimit të gjykatave	Niveli Lokal	Niveli Qendror	Totali 2015	Totali 2014
Mallra dhe Shërbime	740,245	834,504	1,574,748	1,391,685
Komunali	71,139	91,421	162,560	79,155
Subvencione dhe Transfere	148,688	800,872	949,560	335,845
Investime Kapitale	3,152,057	1,258,344	4,410,401	4,364,151
Totali	4,112,129	2,985,141	7,097,269	6,170,836

Tabela 6: Pagesat drejtpërdrejt nga Thesari

Pagesat drejtpërdrejt nga Thesari	Niveli Lokal	Niveli Qendror	Totali 2015	Totali 2014
Mallra dhe Shërbime	307,446	408,672	716,118	441,412
Komunali	166,580	4,150	170,730	0
Investime Kapitale	2,476,845	1,038,620	3,515,465	3,037,443
Totali	2,950,871	1,451,442	4,402,313	3,478,855

¹³ LMFPP neni 39.2 dhe 40 – sipase Neni 39.2 kur një fatur nuk është paguar nga OB-ja për një periudhë më të gjatë se 60 ditë, operatori ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin e pagesës drejtpërdrejt nga MF/Thesari. MF/Thesari ka të drejtë të ekzekutojë pagesën drejtpërdrejt në llogari të operatorit ekonomik sipas kërkesës së tij. Gjithashtu sipas nenit 40 të kryej pagesa si rezultat të vendimeve gjyqësore.

Shkaqet kryesore të pagesës së faturave drejtpërdrejtë nga Thesari dhe ato me vendim të Gjykatave janë si vijon :

- Fillimi i projekteve kapitale në mungesë të buxhetit të mjaftueshëm për financimin e tyre të plotë;
- obligime të trashëguara nga qeverisjet e kaluara në nivelin lokal;
- mos pagesa e faturave për punët e kryera për shkak të mos pranimit të punëve dhe kontestimit të cilësisë së tyre nga organet mbikqyrëse; si dhe
- neglizhenca dhe papërgjegjësia e zyrtarëve përgjegjës për menaxhimin e faturave.

Mos kryerja e obligimeve me kohë ka sjell deri te procedurat gjyqësore të kushtueshme dhe të komplikuar si dhe shpenzime shtesë të buxhetit. Njëherit ka ndikuar negativisht në reputacionin e institucioneve publike. Andaj, është më se e nevojshme që Ministria e Financave së bashku me institucionet tjera përkatëse dhe përgjegjësit e tyre të sigurojnë se faturat e operatorëve ekonomik paguhen në mënyrë të rregullt dhe me kohë.

1.7 Opinionet e auditimeve në PVF-të individuale:

ZKA ka kryer auditimin e rregullsisë së PVF-ve për 90¹⁴ OB. Të gjeturat e auditimit për secilën OB reflektohen në opinionin e auditimit të RVF/BRK-së. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur opinionet e dhëna për 2015 të ndara sipas llojit dhe sipas niveleve të qeverisjes.

Tabela 7. Lloji dhe numri i opinionëve për PVF individuale të OB-ve

Entitetet e audituara/ Opinionet	Opinion i pa modifikuar	Opinion i pa modifikuar me Th. Ç	Opinion i kualifikuar me Th. Ç	Opinion i kualifikuar	Opinion i kundërt	Gjithsej
Nivelin Qendror ¹⁵	10	12	1	1	-	24
Niveli Lokal	1	22	5	6	4	38
Agjencitë e Pavarura	19	7	-	3	-	29
Gjithsej	30	41	6	10	4	91

Aneksi II ofron shënime të hollësishme për bazat e modifikimit të opinionëve si dhe për rekomandimet kryesore të bëra për çdo OB.

Opinion i Kundërt është dhënë për katër (4) komuna: Leposaviq, Zveqan, Zubin Potok dhe Mitrovicës Veriore për shkak të nuk kishin përgatitur pasqyra vjetore financiare.

Opinion i kualifikuar është dhënë për dhjetë (10) OB dhe opinion i kualifikuar me theksim të çështjes është dhënë për gjashtë (6) OB. Në kualifikimin e opinionit dhe theksimin e çështjes kanë ndikuar pasurit kapitale, llogaritë e arkëtueshme, pagesat e parregullta, keqklasifikimi i shpenzimeve. Opinion i për AKP-në ishte i

¹⁴ Gjithsej janë 90 raporte dhe janë dhënë 91 opinione, ne raportin e AKP-së janë dhënë dy opinione për AKP-në dhe Fondin e Privatizimit

¹⁵ Përfshihen 19 Ministri, Dogana e Kosovës, Administrata e Kosovës, Zyra e Presidentit, Zyra e Kryeministrit të Kosovës, dhe Kuvendi i Kosovës.

kualifikuar për shkak se shpenzimet për likuidimin e NSH-ve të privatizuara ishin paguar nga Fondi i Mirëbesimit.

1.8 Rekomandimet

Rekomandojmë Qeverinë e Kosovës të siguroj se:

- Ministri i Financave në koordinim me Drejtorin e Thesarit të vendos procese efektive për të siguruar që plani i hartimit të RVF/BRK-së 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë dhe kërkesat e raportimit financiar. Në këtë aspekt, të siguroj buxhetimin e shpenzimeve në kategori ekonomike adekuate. Më tutje, procesi i konsolidimit duhet të përfshij informata plotësuese për llogarit e arkëtueshme, regjistrimin dhe raportimin e plotë të pasurive kapitale, pagesave nga palët e treta si dhe të obligimeve të papaguara;
- Ministri i Financave gjatë përgatitjes së planit të të hyrave dhe ndërmarrjes së masave fiskale duhet të siguroj përfshirjen më aktive të menaxhmentit të dy agjencive (DK dhe ATK) me qëllim që parashikimet buxhetore të jenë më të përafërta. Parashikimet buxhetore duhet të mbështeten në të dhëna të besueshme indikative për rrjedhat e të hyrave për gjatë vitit;
- Ministri i Financave në koordinim me Komisionin për Buxhet dhe Financa duhet të luaj rol më aktiv gjatë diskutimeve buxhetore me OB. Aty ku ka argumente dhe ekziston domosdoshmëria për buxhet shtesë të inkorporohen në buxhetet vijuese. Përderisa, buxheti për projekte kapitale duhet të vendoset vetëm për ato projekte të cilat janë të arsyetuara mirë duke zhvendosur buxhetimin e fondeve drejt qëllimeve apo prioriteteve më të rëndësishme dhe të realizueshme;
- Ministria e Financave/Thesari duhet të shqyrtoj aranzhimet ekzistuese të raportimit për t'iu mundësuar OB-ve ngritje të cilësisë së raportimit financiar. Në këtë aspekt, veprime kyçe duhet të ndërmerren si: përditësimi i planit kontabël i shoqëruar me udhëzime përkatëse, përditësimin e manualit të kontabilitetit dhe rregullave financiare. Me theks të veçantë, hartimi i rregullave për menaxhimin e subvencioneve dhe llogarive të arkëtueshme. Më tutje, duhet të siguroj mbajtjen e trajnimeve të rregullta me zyrtarët përgjegjës të përfshirë në raportimin financiar;
- Ministri i Financave duhet të rris llogaridhënien ndaj zyrtarëve të përfshirë në realizimin e projekteve të financuara nga huamarrja. Vendimi për huamarrje duhet të merret vetëm pas vendosjes së parakushteve si: projekte të dokumentuara mirë dhe të cilat kanë mundësi realizimi. Kjo duhet të bëhet me qëllim të përfitimit të mundësive për zhvillimin e ekonomisë së vendit në aspektin e investimeve publike;
- Ngritjen e efikasitetit dhe forcimin e kontroleve në menaxhimin dhe raportimin e llogarive të arkëtueshme. Të analizohen shkaqet e rritjes së llogarive të arkëtueshme në mënyrë që të nxjerr shkaktarët e dështimit në pagesën e borxheve dhe të shfrytëzohen veprimet ligjore për inkasimin e tyre; dhe
- Thesari/Divizioni për Monitorim në kuadër të MF-së duhet të ushtrojë kontrole më të rrepta të monitorimit në proceset e raportimeve mujore të obligimeve të papaguara. Një rishikim më kritik i raporteve për obligimet e papaguara është i nevojshëm dhe aty ku vonesat dhe vlera e obligimeve është materiale t'a adresoj çështjen tek zyrtarët përgjegjës të organizatës përkatëse.

Rekomandojmë Kuvendin e Kosovës të sigurojë se:

- Qeveria e Kosovës ka bërë një vlerësim për të identifikuar shkaqet që kanë ndikuar në menaxhim jo efikas të proceseve rreth menaxhimit financiarë dhe kontrollit, Përgaditja dhe zbatimi i planeve të veprimit për implementimin e të gjitha rekomandimeve të dala nga ky raport dhe raportet individuale të auditimit, duhet të jetë në fokus të mbikqyrjes nga ana e Kuvendit.

2 Adresimi i Rekomandimeve të dhëna për PVF e vitit 2014

Konkluzioni i Përgjithshëm

Rëndësia e raporteve të Auditimit qëndron në identifikimin e rekomandimeve praktike për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm në qeverisjen dhe menaxhimin e financave publike. Niveli aktual i implementimit të rekomandimeve të auditimit nuk është i kënaqshëm. Rekomandimet e Prioritetit të Lartë janë më pak të implementuara se sa ato të Prioritetit të Mesëm. Një numër i konsiderueshëm i rekomandimeve përsëriten nga viti në vit. Edhe pse Kuvendi kishte kërkuar nga Qeveria një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve të RVA-së 2014, nuk ka pasur përgjigje pozitive nga Qeveria në lidhje me këtë kërkesë. Ngjashëm, shumica e organizatave buxhetore nuk kanë proces sistematik për monitorimin e implementimit të rekomandimeve. Mosimplementimi ndikon që dobësitë e kontrolleve dhe ndikimi i tyre si humbja financiare, të vazhdojnë vit pas viti.

2.1 Hyrje

ZKA në vazhdimësi jep rekomandime për OB-të, për Qeverinë dhe për Kuvendin, për adresimin e dobësive në kontrolle dhe dobësive tjera që identifikohen gjatë auditimeve. Këto rekomandime kanë për qëllim t'u ndihmojnë menaxherëve të lartë të institucioneve që t'i përmirësojnë rregullimet e qeverisjes, ta mbështesin menaxhimin më të mirë të financave publike dhe ofrimin më të mirë të shërbimeve ndaj taksapaguesve. Implementimi i rekomandimeve të dhëna monitorohet në baza vjetore për auditimet e rregullsisë, përderisa rekomandimet e auditimit të performancës rishikohen përgjatë një përcjelljeje specifike. Ky kapitull përmban një përshkrim të shkallës së implementimit të rekomandimeve të vitit 2014 dhe 2013 në të gjitha nivelet.

2.2 Adresimi i rekomandimeve të dhëna në RVA

Rekomandimet e dhëna në RVA-në e vitit 2014 kanë qenë të një rangui të gjerë, dhe i kanë shqyrtuar aranzhimet e kërkuara për të mundësuar prezantim më të saktë dhe të plotë të informatave në Pasqyrat financiare dhe për t'i adresuar sfidat dhe çështjet e dalura nga auditimi i Pasqyrave Financiare të Konsoliduara për vitin 2014. Edhe përkundër rekomandimeve nga ZKA dhe nga Kuvendi, Qeveria e Kosovës nuk kishte përgatitur një plan veprimi për implementimin e rekomandimeve të bëra në RVA. Rrjedhimisht implementimi i tyre ka qenë i pa strukturuar, dhe vlerësimi i saktë i shkallës së implementimit është i vështirë. Megjithatë, shumica e rekomandimeve nuk ishin adresuar. Nga gjithsej 57 rekomandime¹⁶ të dhëna, vetëm 10 janë implementuar plotësisht, 24 janë në proces të implementimit dhe 23 të tjera nuk janë adresuar ende. Për një përmbledhje më të hollësishme referojuni shtojcës III të këtij raporti.

Edhe pse kjo pasqyron një përmirësim të vogël në krahasim me implementimin e rekomandimeve të RVA-së së vitit 2013, disa nga rekomandimet e përsëritura ndër vite janë:

- Sigurimi i transparencës në PVF/BK-së, duke klasifikuar dhe regjistruar të gjitha shpenzimet, në kodet adekuate të shpenzimeve, si dhe prezantimin e plotë të pagesave nga palët e treta;

¹⁶ 38 rekomandime janë dhënë për Qeverinë, 15 për Kuvendin e Kosovës, 2 për kuvendet komunale dhe 2 për Kryetarin e komunës së Prizrenit.

- Zhvillimi dhe zbatimi i një qasje efektive nga OB-të individuale për menaxhim të rrezikut në lidhje me objektivat organizative;
- Futja në përdorim e prokurimit elektronik për të rritur transparencën dhe për të reduktuar procedurat burokratike;
- Gjetja e një zgjidhje të qëndrueshme, kur është fjala për kryerjen e shërbimeve të auditimit të brendshëm në institucionet e pavarura të vogla që janë drejtpërdrejt përgjegjës para Kuvendit, e që do të promovojë pavarësinë dhe llogaridhënien; dhe

Mos implementimi i rekomandimeve në fjalë ka ndikuar që në vazhdimësi të ketë: keqklasifikim dhe raportim të gabueshëm të shpenzimeve në PVF; mungesë të qasjes gjithëpërfshirëse ndaj menaxhimit të rrezikut; mungesë të transparencës në procedurat e prokurimit; mungesë të shërbimeve të auditimit të brendshëm për institucionet e vogla të pavarura; dhe menaxhim joefikas të burimeve në komuna.

Rekomandime të ngjashme janë persëritur edhe në këtë raport dhe duhen masa shtesë dhe angazhim më i madh nga Kuvendi dhe Qeveria në trajtimin e rekomandimeve të AP-së për ta siguruar përmirësimin e nevojshëm në qeverisjen e sektorit publik në Kosovë.

2.3 Adresimi i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale të auditimit për vitin 2014 dhe 2013

Raportet tona individuale ngrisin çështje që kanë të bëjnë me Pasqyrat Vjetore Financiare, Qeverisjen dhe Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Një përmbledhje rreth implementimit të rekomandimeve të vitit 2014 dhe 2013 po e paraqesim në tabelat në vijim, ku rekomandimet janë ndarë sipas prioritetit dhe poashtu është bërë një krahasim në mes të dy viteve.

Organizatat e audituara i kemi ndarë në: Institucione të nivelit qendror¹⁷, Institucionet të pavarura¹⁸ dhe Institucione të nivelit komunal (38 Komuna).

¹⁷ 19 Ministri, Zyra e Kryeministrit, Administrata Tatimore e Kosovës, Dogana si dhe Tamad dhe Fondi i Bashkuar në Sektorin e Arsimit të cilat janë projekte të financuara nga donacionet. Tamad është në kuadër të sektorit të bujqësisë, derisa Fondi i Bashkuar është Donacion i përbashkët i disa vendeve donatore, në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Këto auditimet janë bërë në bazë të marrëveshjeve me pagesë.

¹⁸ Në institucionet e pavarura janë përfshirë Kuvendi i Kosovës, Zyra e Presidentit, Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe 25 institucione tjera.

Tabela 8. Zbatimi i rekomandimeve të AP-së, dhënë OB-ve për vitin 2014

Subjektet e audituara	Nr i rekomandimeve		Prioriteti	Plotësisht të adresuara		Pjesërisht të adresuara		Të pa adresuara	
	Total	Sipas prioritetit		Nr	%	Nr	%	Nr	%
Institucionet e nivelit qendror	347	222	L	78	35	77	35	67	30
		125	M	55	44	41	33	29	23
Institucionet e pavarura	200	110	L	43	39	41	37	26	24
		90	M	51	57	16	18	23	26
Institucionet e nivelit lokal	630	489	L	87	18	200	41	202	41
		141	M	42	30	43	30	56	40
Rekomandime të nivelit të lartë		821	L	208	25	318	39	295	36
Rekomandime të nivelit të mesëm		356	M	148	42	100	28	108	30
Totali i të gjitha rekomandimeve	1177	1177		356	30	418	36	403	34

Tabela 9: Zbatimi i rekomandimeve të AP-së, dhënë OB-ve për vitin 2013

Subjektet e audituara	Nr i rekomandimeve		Prioriteti	Plotësisht të adresuara		Pjesërisht të adresuara		Të pa adresuara	
	Totali	Sipas prioritetit		Nr	%	Nr	%	Nr	%
Institucionet e nivelit qendror	313	197	L	41	21	72	37	84	43
		113	M	55	49	23	20	35	31
Institucionet e pavarura	199	107	L	42	39	28	26	37	35
		95	M	62	65	9	9	24	25
Institucionet e nivelit lokal	521	423	L	95	22	153	36	175	41
		98	M	41	42	19	19	38	39
i Rekomandime të nivelit të lartë		727	L	178	24	253	35	296	41
Rekomandime të nivelit të mesëm		306	M	158	52	51	17	97	32
Totali i të gjitha rekomandimeve	1033	1033		336	33	304	29	393	38

Ne e kategorizojmë rëndësinë e rekomandimeve të bëra. Rekomandimet me prioritet të lartë janë ato të cilat, nëse nuk adresohen mund të rezultojnë me dobësi materiale në kontrollin e brendshëm, derisa rekomandimet me prioritet të mesëm janë çështjet të cilat mund të mos rezultojnë me dobësi materiale, por ku veprimi i marrë ofron mundësinë për përmirësimin e kontrolleve të brendshme.

Pozicioni i përgjithshëm është se ka pasur një rritje të numrit të rekomandimeve në vitin 2014 për të gjitha llojet e institucioneve. Një pjesë e madhe e rekomandimeve të 2014, të prioritetit të lartë nuk janë adresuar dhe konkluzioni i njëjtë vlen edhe për rekomandimet e prioritetit të mesëm. Kjo është një çështje shqetësuese dhe duhet të trajtohen me prioritet.

Sikur edhe në rishikimin e rekomandimeve të RVA-së më lartë, shumë rekomandime përseriten çdo vit. Fushat kryesore ku ka ndodhur kjo, kanë të bëjnë me: shpalosjet e informatave në PVF; klasifikimin e shpenzimeve; realizimin e buxhetit; prokurimin dhe menaxhimin e pasurive. Mos adresimi i rekomandimeve të dhëna ka rezultuar në dobësi të vazhdueshme në kontrollin e brendshëm, duke e zvogëluar kështu efektivitetin e aktiviteteve të OB-ve, shpalosje jo të duhur të informatave në PVF, mos arritje të vlerës për para dhe në raste të caktuara me pagesa të parregullta.

Kjo situatë do të adresohet vetëm nëse rritet përkushtimi përmes monitorimit të rregullt të implementimit të rekomandimeve nga të gjitha OB-të duke i identifikuar dhe adresuar pengesat në implementim. Shembulli se si monitorimi i rregullt i progresit, ka ndihmuar në adresimin e rekomandimeve, mund të shihet tek MIE, MMPH dhe MTI. Këto Ministri, nëpërmjet monitorimit të rregullt të progresit kanë arritur një nivel relativisht të lartë të implementimit të rekomandimeve në krahasim me vitet paraprake.

2.4 Adresimi i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit të performancës

Në sezonin e auditimit 2015/2016, ZKA e ka bërë një auditim përcjellës për Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” (ANP-AJ). Ky auditim ka treguar se nga gjithsej 8 rekomandime sa ishin dhënë, ANP-AJ kishte implementuar plotësisht 4 rekomandime, në proces të implementimit apo të implementuara pjesërisht ishin 3 rekomandime, dhe 1 rekomandim nuk ishte implementuar. Rekomandimi i paimplementuar ka të bëjë me disa punë të pakryera, apo përfundimin e disa punëve të mbetura, të cilat ndërlidhen me zonën e KFOR-it brenda pronës së ANP-AJ.

Rekomandimet plotësisht të adresuara kryesisht kanë të bëjnë me çështje administrative dhe të dokumentacionit (si hartimi i rregullores nga Komiteti për Partneritete Publiko Private, takimet procesverbalet etj; krijimi i njësisë së përhershme për menaxhim të projektit, përcaktimi i afateve të raportimit dhe dhënia e lejes ndërtimore). Derisa rekomandimet e adresuara pjesërisht më shumë kanë të bëjnë me punë të cilat janë paraparë në marrëveshje por nuk janë realizuar plotësisht.

Përveq kësaj, dy raporte tjera janë shqyrtuar në Komisionin Parlamentar për Mbikqyrje të Financave publike (Raporti i Auditimit – mirëmbajtja dhe riparimi i veturave zyrtare dhe Raporti i Auditimit – sistemet e prokurimit në sektorin e shëndetësisë). Veprimi i vetëm deri më tani, me ndikim në zbatimin e rekomandimeve, ishte përgatitja me vonesë e një plani të veprimit nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë për adresimin e rekomandimeve të dhëna në raportin - sistemet e prokurimit në sektorin e shëndetësisë. Derisa planet e veprimit në lidhje me raportin tjetër kanë qenë të kërkuara nga ZKA, por nuk janë ofruar nga Administrata Tatimore e Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Ministria e Administratës Publike, Dogana e Kosovës dhe nga Policia e Kosovës.

2.5 Arsyet për zbatim të ulët të rekomandimeve

Mungesa e proceseve formale për monitorimin sistematik të planeve të veprimit dhe implementin e rekomandimeve si dhe mungesa e përkushtimit të mjaftueshëm për implementim të rekomandimeve janë ndër shkaktarët kryesor të mos adresimit adekuat të rekomandimeve të AP-së. Poashtu mungesa e mbikqyrjes efikase nga e Qeverisë dhe organeve mbikqyrëse ka ndikuar që organizatat buxhetore të shmangin zbatimin e plotë dhe konsistent të udhëzimeve për menaxhimin e shpenzimeve duke rezultuar me gabime dhe rekomandime të përsëritura.

2.6 Rekomandimet e përgjithshme

Rekomandojmë Kuvendin e Kosovës që:

- Të kërkojë nga Qeveria një raport kthyes në lidhje me rekomandimet e dhëna nga AP në RVA 2014, dhe rekomandimet e Komisionit për Mbikqyrje të Financave Publike, që ndërlidhen me këtë raport (duke detajuar progresin e arritur dhe duke identifikuar barrierat që kanë penguar implementimin e plotë të rekomandimeve); dhe
- Të kërkojë nga Qeveria që të përgatisë një plan veprimi për implementimin e rekomandimeve të AP-së në RVA 2015 dhe raporte në lidhje me progresin e zbatimit të këtij plani, në baza tremujore. Këto raporte duhet të sqarojnë qartë pse rekomandimet e paimplementuara nuk mund të implementohen.

Rekomandojmë Qeverinë që:

- Të zbatojë një proces sistematik për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga AP në RVA 2015 dhe RVA të mëhershme. Ky proces duhet ti identifikojë qartë dhe ti adresojë barrierat në implementimin e rekomandimeve; dhe
- Të kërkojë nga të gjitha Organizatat buxhetore që të implementojnë dhe raportojnë mbi procesin sistematik të implementimit të rekomandimeve të auditimit, me raporte tremujore të progresit të dërguara në Ministri të Financave dhe në KMFP. Këto raporte duhet të sqarojnë qartë pse rekomandimet e paimplementuar nuk mund të implementohen.
- Të përcjell për së afërmi nivelin e implementimit të rekomandimeve të AP-së duke ftuar Ministrinë e Financave që të paraqesë gjendjen e rekomandimeve në njërën prej mbledhjeve të Qeverisë.

3 Qeverisja e Mirë

Konkluzion i Përgjithshëm

Zhvillimet në qeverisje janë promovuar përmes implementimit të një kornize të fokusuar në përmirësimin e kontroleve të brendshme dhe të menaxhimit financiar, si dhe në zhvillimin e kapaciteteve menaxhuese. Këto janë demonstruar përmes strategjisë së KBFP për vitet 2015-2019, dhe përmes punës nga Departamenti Qëndror Harmonizues (DQH), duke përfshirë këtu edhe mbështetjen e dhënë për njësitë e auditimit të brendshëm. Vetvlerësimi për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) që çdo vit dorëzohet në Ministrinë e Financave (MF) është bazë për monitorimin e zhvillimeve në qeverisje. Edhe pse ka zhvillime pozitive, këto iniciativa ende nuk janë plotësisht efektive dhe një pjesë të madhe të OB-ve (43%) u mungojnë planet strategjike efektive dhe dy të tretave (2/3) prej tyre u mungojnë kostot financiare të planeve/strategjive. Pothuajse 80% të OB-ve nuk kanë sisteme efektive të menaxhimit të rrezikut, pavarësisht se kjo është kërkesë aktuale e përcaktuar nga Qeveria. Rreth 27% e njësive të auditimit të brendshëm kanë mungesë stafi bazuar në madhësitë e tyre dhe rreth një e katërta (1/4) e punës së tyre nuk është e fokusuar në vitin aktual. Pak më shumë se gjysma e rekomandimeve të auditimit të brendshëm janë zbatuar. Këto gjetje theksojnë nevojën për rritje të konsiderueshme të fokusit në çështjet të qeverisjes nga ana e menaxherëve të sektorit publik, nga Qeveria dhe Kuvendi

3.1 Hyrje

Qeverisja e mirë ka të bëjë me implementimin e politikave efektive dhe proceseve që sigurojnë se objektivat organizative (siç përcaktohet në planet vjetore dhe strategjike) janë arritur në mënyrë ekonomike dhe efikase brenda afateve të pritura kohore. Qeveria e mbështet agjendën e qeverisjes përmes zbatimit të një kornize për promovimin e praktikave të mira përmes një strategjie të përgjithshme të KBFP-ës e cila thekson:

- Integrimin e burimeve dhe kontroleve ndaj in puteve në proceset dhe sistemin e menaxhimit të financave publike deri më 2017;
- Ekziston llogaridhënia menaxheriale për in putet dhe menaxhimin e burimeve e vërtetuar nga raportet e përgatitura nga menaxherët e fondeve publike deri më 2017-2018;
- Menaxhimi i rrezikut vendoset në të gjitha OB, i vërtetueshëm nga strukturat dhe raportet e menaxhimit të rrezikut deri më 2017; dhe
- Funkcioni i auditimit të brendshëm ti shtojë vlerë menaxhimit llogaridhënës duke ofruar siguri të përqendruar në rrezik dhe shërbime këshillimore, të vërtetueshëm nga tregues ekonomik, efikas, dhe efektiv deri më 2019.

Mjetet kyçe në dispozicion për t'i mbështetur subjektet e sektorit publik që t'i zbatojnë aranzhimet pozitive të qeverisjes përfshijnë një pyetësor vetë-vlerësimi, i cili i dërgohet MF në bazë vjetore nga ana e OB individuale, dhe punën e DQH përmes trajnimeve lidhur me ngritjen e njohurive dhe vetëdijes për MFK-në dhe për sistemin e Auditimit të Brendshëm.

DQH është përgjegjës për hartimin e dokumenteve dhe politikave për zhvillimin dhe monitorimin e MFK dhe AB, poashtu ndihmon, monitoron dhe kryen vlerësime të jashtme që kanë të bëjnë me rishikimin e sigurimit

të cilësisë së kryerjes së auditimit të brendshëm në subjektet e sektorit publik. DQH ka organizuar seminare për menaxherët e lartë dhe auditorët e brendshëm rreth rëndësisë së procesit të vetvlerësimit dhe menaxhimit të rreziqeve. Gjithashtu, ka bërë përshkrimin e proceseve të MFK-së në një numër të organizatave të përzgjedhura pilot (në dy komuna dhe në dy ministri) me synimin që ato të përdoren si model i mirë në organizatat tjera buxhetore.

Zhvillimet në qeverisje janë duke u mbështetur edhe nga reforma e administratës publike. Në këtë kontekst, Qeveria synon ta integroj Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) dhe Doganën e Kosovës në një agjenci të vetme. Objektivi i kësaj do të jetë që bizneseve/tatimpaguesve, përmes një sistemi të modernizuar të mbledhjes së të hyrave, t'ju ofroj shërbime më të shpejta, më të mira dhe me kosto më të ulët, por edhe që të krijoj shtytje për zhvillim të biznesit.

3.2 Mbështetja nga Zyra Kombëtare e Auditimit për agjendën e qeverisjes

3.2.1 Hyrje

ZKA ka një rol kyç në mbështetjen e zhvillimeve të qeverisjes. Kjo adresohet përmes një programi të punës i cili është i bazuar në rrezik (i fokusuar në ato fusha ku puna e tillë pritët të ketë ndikim maksimal) dhe reflekton pjesërisht mbi iniciativat kryesore të zbatuara nga Qeveria.

Ne raportojmë mbi:

- Punën specifike që e kemi kryer për çdo auditim;
- Fushat e përbashkëta të trajtuara nëpër të gjitha auditimet, ku procesi i planifikimit të auditimit ka theksuar nevojën për ti trajtuar fushat e veçanta të aktiviteteve, me theks në aranzhimet e qeverisjes; dhe
- Çështje specifike të ndërlidhura me MFK të identifikuar në auditimet tona në 2015.

3.2.2 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

Në pjesë të konsiderueshme të fushave të aranzhimeve të qeverisjes nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ne besojmë se përmes rekomandimeve tona do të ndikojmë në përmirësime pozitive. Trajtimi i çështjeve të ngritura në raportet e auditimit të ZKA-së dhe zbatimi i rekomandimeve nga menaxhmenti i OB-ve do të zhvilloj proceset dhe kontrollet ekzistuese drejt një qeverisje më efektive.

Mungesa e llogaridhënies dhe përgjegjësisë menaxheriale ka ndikuar në efikasitetin e kontrolleve buxhetore, raportimin financiar dhe monitorimin. Aktivitetet të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si adresimi i plotë i rekomandimeve të auditimit dhe zhvillimi i një procesi të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm të cilësisë së lartë duhet të avancohet tutje. Zotimet e menaxhmentit të OB gjatë shqyrtimit të raporteve vjetore të auditimit në Komisionin parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP) se rekomandimet e do të adresohen, në shumicën e rasteve kanë mbetur vetëm zotime të pa realizuara.

Janë evidentuar mangësitë në përcaktimin e objektivave dhe veprimeve të qarta në planet strategjike si nga qeverisja qendrore dhe vetëqeverisja lokale. Ka raste të mungesës së ndërlidhjes mes planeve strategjike, kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) dhe programeve vjetore. Përveç tjerash këto dokumente nuk përmbajnë vlerësime të rrezikut për aktivitetet e planifikuara. Rreziqet apo barrierat menaxhohen sipas rastit e jo sipas ndonjë plani të strukturuar.

Aktivitetet operacionale jo gjithëherë realizohen sipas planifikimeve fillestare. Programet vjetore të punës pësojnë ndryshime gjatë vitit buxhetor, blerjet vjetore nuk planifikohen si duhet apo nuk bazohen sa duhet në nevojat reale të organizatave. Devijimet nga plani shpeshherë kanë edhe efekte buxhetore, në shumë raste OB kanë përfunduar me borxhe financiare të konsiderueshme.

Procedurat e duhura të MFK-së vazhdojnë të mos zbatohen sa duhet. Me përjashtim të rasteve të pakta, udhëzimet dhe procedurat e brendshme pothuajse nuk ekzistojnë nëpër organizata individuale buxhetore. Parregullsitë dhe dobësitë menaxheriale janë evidente në shumë fusha, duke filluar nga planifikimi i buxhetit, shpenzimi i fondeve publike, planifikimi dhe implementimi projekteve kapitale, menaxhimi i kontratave, delegimi i detyrave dhe përgjegjësi, raportimi financiar dhe menaxherial, udhëheqja e personelit si dhe menaxhimi i obligimeve dhe pasurisë publike.

3.2.3 Rishikimi i Qeverisjes në auditimet individuale

Lista kontrolluese e vetë-vlerësimit e MFK-ës

MF/DQH ka hartuar një listë të detajuar kontrolluese të vetëvlerësimit që kërkon nga OB ta vlerësojnë veten kundrejt 106 pyetjeve të cilat adresojnë fushat më të rëndësishme të qeverisjes. Kjo i mundëson MF-it t'i vlerësoj zhvillimet e përgjithshme të qeverisjes dhe ti identifikoj çështjet për të cilat OB-të kërkojnë mbështetje të mëtejme.

Që pyetësi i vetëvlerësimit të jetë një mjet efektiv për përmirësimin, dëshmitë që e mbështesin vlerësimin individual nga çdo OB duhet të jetë një reflektim i saktë i situatës aktuale, që d.m.th. të bazuara në dëshmi. Për këtë arsye në të gjitha auditimet e 2015 ne kemi ndërmarrë punën për ta përcaktuar cilësinë e aplikimeve të bëra, duke vlerësuar 6 pyetjet kryesore nëpër të gjitha pesë komponentët e listës së kontrollit, për të përcaktuar nëse kontrollet ishin të vendosura dhe, nëse po, të vlerësojmë nëse ky konkluzion është mbështetur me dëshmi. Tabela më poshtë prezanton vlerësimet e nxjerra nga auditimet individuale për 89 OB, përfshirë Ministrinë, Komunitet dhe Institucionet e Pavarura (IP).

Pyetja	Vlerësimi i ZKA-së.
A ka OB plan strategjik, dhe a janë përfshirë menaxherët e strukturave/ njësive vartëse në diskutimet për planin strategjik? Po palët e treta?	Vetëm 57% e OB-ve kanë planin strategjik, apo 51 nga gjithsej 89 OB të testuara. Mungesa e planeve sidomos është më e theksuar te Komunat, ku 18 prej tyre ende nuk kanë plan strategjik. Përfshirja e palëve të interesit në procesin e hartimit të planeve është shumë ulët. Në përcaktimin e objektivave strategjike kryesisht përfshihen menaxherët e strukturave.
A llogaritet kostoja e strategjisë?	63% e OB nuk e kanë llogaritë koston financiare të strategjisë.
A merren parasysh gjatë procesit të planifikimit rreziqet e mundshme nga burimet e jashtme? (p.sh. Lidhur me furnizimin e shërbimeve nga jashtë, teknologji, kushtet ekonomike dhe politike, kërkesat ligjore, ngjarjet natyrore, pengesa pronësore, etj.)	78% apo 69 OB nuk kanë përgatitë planin për menaxhimin e rreziqeve dhe nuk marrin parasysh rreziqet e mundshme. Komunat kanë ngecje më të mëdha në këtë drejtim.
A ka një plan prokurimi të miratuar kundrejt disponueshmërisë së fondeve buxhetore të miratuara? A azhurnohet ai gjatë vitit në përputhje me ndryshimet e fondeve në dispozicion të OB?	86% e OB-ve kanë plane të prokurimit të miratuara kundrejt disponueshmërisë së fondeve buxhetore.
A e mbështet sistemi i raportimit hartimin, në kohën e duhur për vendimmarrjen, e raporteve operationale të mëposhtme. P.sh. Raportet për ekzekutimin e buxhetit, procesi i komunikimit dhe raportimit të brendshëm, etj.;	Në 84% të rasteve sistemi i raportimit e mbështet hartimin në kohën e duhur të raporteve operationale për vendimmarrjen.
A monitorohet rregullisht progresi lidhur me arritjen e objektivave dhe a analizohen shkaqet për dështimet e mundshme në këtë drejtim?	Në 50% të rasteve mungon monitorimi i rregullt i progresit lidhur me arritjen e objektivave dhe analizimin e shkaqeve për dështimet e mundshme.. Kjo sidomos është më e theksuar te organizatat e nivelit komunal.

Në kontekst të kontrolleve të pritura, rishikimi tregon:

- Zbatim të dobët të planeve strategjike dhe në veçanti një shqetësim për shumicën e planeve ekzistuese strategjike që nuk kanë kosto të implementimit - si e tillë është e paqartë nëse planet që ekzistojnë në të vërtetë janë të arritshme;
- Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut nuk janë vendosur në shumicën e OB. Edhe në ato pak OB që konsiderohet se kanë filluar me këtë proces, aktivitetet formale të ndërmarra në menaxhimin e rrezikut janë të mangëta;
- Bashkërendimi i aktiviteteve të planifikuara me programin e prokurimit dhe buxhetit si dhe analizat dhe raportimi financiar konsiderohen si të vendosura nga OB-të, dhe dëshmitë e siguruara deri diku e mbështesin këtë konkluzion porse formati dhe cilësia e informacionit që përmbajnë këto raporte

është e dobët dhe e pamjaftueshme. Disa OB ende nuk kanë vendosur një sistem të mirëfilltë të informimit dhe komunikimit.

- Proceset efektive të monitorimit dhe vlerësimit të progresit në përmbushjen e objektivave të përcaktuara me planet vjetore dhe ato strategjike ende nuk janë vendosur në shumicën e OB. Kjo e pamundëson vendimmarrjen me kohë dhe reagim të menjëhershëm nga ana e menaxhmentit në adresimin e barrierave të cilat pengojnë arritjen e qëllimeve dhe objektivave të organizatës.

Listat kontrolluese të vetëvlerësimit, nuk i reflektojnë qartë aranzhimet aktuale qeverisëse. Kjo ngase nuk është kuptuar sa duhet qëllimi dhe përmbajtja e procesit të vetëvlerësimit. Për më shumë, veprimi i ndërmarrë për adresimin e çështjeve të identifikuara nga vetëvlerësimi i vitit paraprak është i kufizuar. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë brenda OB që ka të bëjë me rëndësinë e kësaj liste kontrolluese dhe me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative. Trajnimet në lidhje me vetëvlerësimin duket se ishin të pamjaftueshme pasi që në disa organizata vërehet se ka mbivlerësime ose anashkalime të vlerësimeve nëpër komponentë të ndryshme. Për dallim nga vitet e kaluar, vlerësimi i procesit të MFK-së nga menaxhmenti është më objektiv në vitin 2015.

3.2.4 Sistemi i Auditimit të Brendshëm

NjAB dhe KA kanë një rol kyç për ta mbështetur dhe promovuar qeverisjen e mirë. Në nivel qendror dhe lokal kjo mbështetet nga DQH dhe iniciativat kryesore në vitin 2015 kanë përfshirë:

- Organizimin e trajnimeve për auditorët fillestar në fushën e AB, edukimin e vazhdueshëm profesional, trajnime në programin për vlerësim të cilësisë, dhe trajnime në përgatitjen e planit strategjik dhe vjetor bazuar në rrezik, trajnimin e AB rreth ndryshimeve në versionin e ri të SIMFK-së; dhe
- Me qëllim shkëmbimin e përvojave praktike janë kryer dy pilot auditimet, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Komunën e Lipjanit¹⁹.

Përmes Strategjisë së KBFP për vitet 2015-2019, kërkohet avancim i auditimit të brendshëm që ju ndihmon OB në fuqizimin e kontrollit të brendshëm. Arritja e kësaj objekteve të përcaktuara me këtë strategji ndërlidhet me ekzistimin e kornizës ligjore në harmoni me SNPPAB (Standardet Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale të Auditimit të Brendshëm), ekzistimi i programit për zhvillimin e vazhdueshëm profesional si dhe siguri në cilësi për pajtueshmëri me SNPPAB-të. Rritja e numrit të auditorëve të brendshëm të certifikuar nga 32 në 67 si dhe arritja e marrëveshjes me CIPFA-në, për vazhdimin e programit të certifikimit të drejtpërdrejtë nga MF/DQH paraqet një zhvillim pozitiv në këtë drejtim.

Fokusi ynë në auditimin e brendshëm në 2015 ka përfshirë vlerësimin e përbashkët për disa fusha kyçe. Rezultatet janë prezantuar në tabelën në vijim.

¹⁹ Raporti i vitit 2015 për funksionimin e sistemit të KBFP në sektorin publik të Kosovës, i përgatitur nga MF/DQH.

Pyetja	Vlerësimi nga ZKA
A është numri i stafit të AB-së në përputhje me numrin e duhur duke e pasur parasysh madhësinë e OB-së ?	27% e NJAB nuk kanë numrin e mjaftueshëm të stafit, ndërsa nëntë OB nuk kanë themeluar fare NJAB.
A ekziston plani i auditimit i bazuar në rrezik?	92% e planeve të AB janë të bazuara në rrezik.
Çfarë proporcioni i punës së AB-së ndërlidhet me vitin aktual?	76% e punës së AB ka qenë e fokusuar në aktivitetet e vitit aktual.
A është i vendosur një komitet efektiv i auditimit që e rishikon dhe e mbështetë punën e Auditimit të Brendshëm ?	20% e OB nuk e kanë themeluar KA. Prej komiteteve aktive, 80% e tyre janë efektive dhe mbështesin punën e AB.
A janë zbatuar shumica e rekomandimeve të auditimit të brendshëm (ne %)?	54% e rekomandimeve janë implementuar plotësisht, 26% janë në proces të implementimit, ndërsa 20% e rekomandimeve mbeten të pa implementuar ²⁰ .

Vlerësimet tregojnë një zhvillim pozitiv në auditimin e bazuar në rrezik (sidomos në nivel qendror) por efektiviteti i përgjithshëm i AB zvogëlohet aty ku kapaciteti i njësisë është më pak se sa nevojitet për madhësinë e organizatës dhe ku një pjesë e punës nuk ka të bëjë me vitin aktual. Kjo mund të ndikojë negativisht në nivelin e sigurisë që i ofrohet menaxhmentit mbi efektivitetin ose mos efektivitetin e kontrollit të brendshëm për shkak të punës së pamjaftueshme. Derisa pak më shumë se gjysma e rekomandimeve të auditimit të brendshëm janë duke u implementuar, dobësitë e kontrollit nuk po adresohen efektivisht duke rezultuar në joefikasitet të vazhdueshëm operacional dhe potencialisht në humbje financiare.

Edhe aty ku është kryer punë që ndërlidhet me periudhën aktuale, auditimet mbeten të orientuara drejt pajtueshmërisë dhe më pak të përqendruara në ndryshimet sistematike dhe në përmirësim. Në 16 OB, kryesisht në Komuna (13) nuk është punësuar numri i mjaftueshëm i auditorëve të brendshëm. Kjo mund të ketë limituar planet e auditimit që të jenë më gjithëpërfshirëse. Mund të jetë kjo një nga arsytet që zhvillimet e auditimit të brendshëm në nivelin lokal kanë ngecje në krahasim me nivelin qendror. Mungesa e numrit të mjaftueshëm të auditorëve të brendshëm është evidente edhe në IP.

Në 2 agjenci, 16 komuna dhe në Ministrinë e Diasporës nuk ka Komitet Auditimit (KA), ndërkohë që rreth 20% e KA-ve, kryesisht në nivel lokal, nuk janë efektive dhe nuk sigurojnë mbështetjen e duhur. Dobësitë e KA-ve e zvogëlojnë ndikimin e mundshëm të aktivitetit të AB në mbështetjen e përmirësimeve në qeverisje.

Rregulla e Qeverisë për pagesën e kompensimeve²¹ të anëtarëve të komitetit të auditimit dhe të komisioneve tjera ka shkaktuar paqartësi nga njëra organizatë në tjetrën. Rregulla nuk e ka definuar qartë nëse kompensimet duhet të bëhen për të gjithë anëtarët e komitetit/komisionit, qofshin ata punonjës të OB-së apo jo, apo vetëm për anëtarët e jashtëm.

²⁰ DHQ :Raporti për funksionimin e sistemit të Kontrollit të Brendshëm të financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2015

²¹ Neni 80 i LMFPF ndalon kompensimin shtesë për zyrtarët të cilët sipas një akti të Qeverisë kërkohet të shërbejnë në komisione/komitete të ndryshme, pasi ky shërbim konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të postit të cilin e mban i punësuar.

3.2.5 Fushat e përbashkëta të shqyrtuara në auditimet e ZKA-së

Menaxhimi i rrezikut

Nga OB kërkohet që të zhvillojnë një proces të menaxhimit të rrezikut, të zbatojnë procedurat e nevojshme dhe të kenë planin për menaxhimin e rrezikut²². Ky plan duhet të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv, operacional dhe strategjik, si dhe të jetë i integruar në planet dhe aktivitetet e përditshme të institucionit. Regjistri i rrezikut mund të nxjerrë në pah rreziqet e natyrave të ndryshme si: ato financiare, teknologjike, sociale, politike, ligjore etj. Kërkesa kryesore është të ndërmerren veprime për të zbutur apo eliminuar rreziqet e identifikuara.

Menaxhimi i rrezikut si proces ishte fushë e përbashkët e shqyrtimit në të gjitha auditimet individuale të ndërmarra nga ZKA. Shumica e OB-ve nuk kanë krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve në nivel të organizatës. Mungojnë regjistrat konkret për menaxhimin e rreziqeve. Edhe në ato pak OB që kanë filluar me këtë proces, cilësia e aktiviteteve të ndërmarra është e dobët dhe/ose procesi për menaxhimin e rrezikut është i paqartë. Menaxhmenti ende nuk e kupton rolin dhe rendësin që ka ky proces në qeverisjen efikase të aktiviteteve të organizatës.

Mungesa e planeve strategjike në disa OB zvogëlon përfitimin e mundshëm nga menaxhimi i rrezikut i cili ka për qëllim të mbështesë arritjen e objektivave të organizatës. Gjithashtu kjo zvogëlon cilësinë rezultateve dhe shërbimeve, pasi çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë mund të mos jenë adresuar në kohën e duhur. Në një situatë të tillë, veprimet e nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e rreziqeve mund të mos ndërmerren në mënyrë të organizuar dhe sistematike. Përveç devijimit nga rezultatet e pritura, efekti i kësaj do të jetë edhe ngritja e kostos financiare në menaxhimin e pasojave si rezultat i veprimeve të vonuara.

3.3 Zhvillimet e reja në menaxhimin e punonjësve në sektorin publik

Një sistem i shërbimit publik i planifikuar dhe menaxhuar mirë i ndihmon institucioneve shtetërore të arrijnë një nivel të duhur të profesionalizmit, qëndrueshmërisë dhe cilësisë së shërbimit publik ndaj qytetarëve dhe bizneseve. Reformimi i shërbimit publik ka ndikim të veçantë në krijimin e një administrate publike efektive dhe qeverisje të mirë në shërbimin publik. Disa nga zhvillimet në këtë drejtim janë:

- Draft ndryshimi i Ligjit për Shërbimin Civil (LSHC) dhe ai për pagat e nëpunësve publik;
- Aprovimi i Ligjit për Procedurat Administrative;
- Finalizimi i procesit të klasifikimit dhe sistematizimit të vendeve të punës në OB;
- Fillimi i zbatimit të Sistemit të Informacionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SMIBNJ), përmes së cilit do të lehtësohet menaxhimi personelit dhe grumbullimi i të dhënave për të punësuarit e të gjitha institucioneve; dhe

²² Menaxhimi i rrezikut është një proces dhe plan i projektuar për të identifikuar ngjarjet e mundshme apo rreziqet që mund të kenë efekt negativ për organizatën. Përmes këtij procesi vlerësohet niveli i rrezikut si dhe planifikohen veprimet e nevojshme që duhet të ndërmerren për ta eliminuar atë apo për ta mbajtur brenda kufirit të pranueshëm drejt arritjes së planit dhe objektivave të organizatës.

- Ofrimi i trajnimeve për punonjësit publik nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike.

Me gjithë zhvillimet në drejtim të plotësimit dhe ndryshimit të kornizës ligjore, ngecjet janë evidente në zbatimin e tyre. Ndonëse me vonesë, Qeveria ka aprovuar katalogun dhe klasifikimin e vendeve të punës për nëpunësit civil, si një standard referimi për përdorim nga të gjitha institucionet e shërbimit civil. Përkundër aprovimit, katalogu dhe sistemi i ri i pagave ende nuk kanë gjetur zbatim në praktik.

Këto zhvillime do të mundësonin një organizim më efikas të administratës shtetërore, nivelizim të pagave për angazhimet e njëjta të përgjegjësisë në cilindo nivel të shërbimit publik (pagesa e njëjtë për punën e njëjtë), standardizimin e titujve dhe përshkrimin e qartë të vendeve të punës, transferim të nëpunësve ndërmjet institucioneve në rastet kur ajo është adekuate, etj. Kjo do të përmirësonte performancën e institucioneve dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët dhe organizatat nga ana e institucioneve.

Me gjithë përpjekjet e Qeverisë në drejtim të avancimit të sistemit të shërbimit publik, auditimet tona individuale të kryera për OB tregojnë dobësi në zbatimin e kërkesave dhe procedurave ligjore në menaxhimin e personelit dhe pagesave të kompensimeve. Kjo veçanërisht theksohet te rekrutimi i personelit, mbajtja e pozitive menaxhuese me ushtrues detyre përtej afatit kohor ligjor, angazhimi i punëtorëve me Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta pa aplikuar procedura, avancim në karrierë pa procedura të avancimit, etj.

3.4 Rekomandimet

Ne rekomandojmë Qeverinë që të sigurojë se:

- Është fuqizuar më tutje përgjegjësia menaxheriale nëpër organizatat buxhetore për të siguruar një mjedis më efikas të kontrollit të brendshëm, në rritjen e efektivitetit të AB-së dhe adresimin me kohë të rekomandimeve të auditimit. Derisa aprovimi i ligjit në pritje për KBFP si dhe kompletimi i akteve përcjellëse nënligjore do të rregullojë dhe zhvillojë më tutje sistemin e menaxhimit financiar dhe të kontrolleve në tërësi;
- Proceset efektive të menaxhimit të rrezikut ndërmerren nga të gjitha OB-të, dhe se adresojnë barrierat për përmirësim në këtë fushë. DQH të vazhdoj ofrimin e trajnimeve menaxheriale për procesin e vetëvlerësimit dhe të menaxhimit të rrezikut, të identifikoj praktika të mira në OB-të e zgjedhura dhe ato të ndahen me të tjerat. Auditim i brendshëm të ketë një rol më aktiv në mbështetjen e këtij procesi;
- OB-të të hartojnë rregullore dhe procedura të brendshme përmes së cilave jepen udhëzimet e nevojshme në administrimin e përditshëm të aktiviteteve financiare dhe operative. Informimi dhe raportimi i brendshëm përfshirë edhe monitorimin e menaxhmentit të zhvillohet tutje;
- Procesi i vetëvlerësimit të menaxhimit financiar dhe të kontrolleve nga ana e OB-ve të fuqizohet më tutje për ngritjen e objektivitetit dhe cilësisë së vlerësimit në tërësi. Në këtë drejtim, DQH të vazhdoj ofrimin e trajnimeve shtesë për menaxherët e OB-ve për rëndësinë e pyetësorit të vetëvlerësimit, për zhvillimin e procesit dhe për potencialin që ai ofron në zhvillimin e qeverisjes së mirë ;
- Është vendosur theksi në zhvillimet e ardhshme të auditimit të brendshëm, në sigurimin e kapaciteteve të duhura të Nja-së në krahasim me madhësinë e organizatave. Gjithashtu me qëllim të rritjes së efektivitetit të auditimit të brendshëm, puna auditues të mbuloj gjithnjë e më shumë

aktivitetet e vitit aktual, të rritet niveli i zbatimit të rekomandimeve të AB-së si dhe ngritjen e efektivitetit të komiteteve të auditimit.

- Trajtohet dhe qartësohet mjaftueshëm çështja e pagesave të kompensimeve shtesë për anëtarët e Komitetit të Auditimit në OB;
- Merret në konsideratë rekomandimi i Komisionit Evropian për hartimin e një koncepti dokumenti i cili qartëson fushëveprimin e LSHC, statusin e nëpunësve civil në raport me kategoritë tjera të punësuarve, qartësimin e kriterëve të pranimit në SHC, depolitizimin dhe profesionalizmin e punonjësve, rregullimin më të qartë të pozitave të nivelit të lartë drejtues, promovimin në karrierë, procedurat disiplinore dhe pezullimin e marrëdhënies së punës;
- SMIBNJ fillon së zbatuari në formë të plotë në të gjitha institucionet shtetërore. Të gjitha informatat e nevojshme për të punësuarit publik të regjistrohen dhe të përditësohen me kohë në këtë sistem; dhe
- Janë finalizuar të gjitha veprimet e nevojshme në fillimin e zbatimit të sistemit të ri të pagave. Menaxhmenti i OB duhet të trajtojë mangësitë e hasura në fushën e menaxhimit të personelit dhe kompensimeve shtesë përmes adresimit të rekomandimeve të dhëna nga ZKA.

Rekomandojmë Kuvendin e Republikës së Kosovës të sigurojë që:

- Qeveria do të trajtojë me prioritet dhe monitorojë implementimin e planit të veprimit për zbatimin e strategjisë për kontrollin e brendshëm të financave publike;
- Në kuadër të Kuvendit të Kosovës krijohet Njësia e Auditimit të Brendshëm për auditimin e Institucioneve të Pavarura të Republikës së Kosovës; dhe
- Përmes KMFP obligon bartësit e OB që të raportojnë në baza të rregullta kohore në lidhje me nivelin e implementimit të rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit.

4 Prokurimi

Konkluzion i përgjithshëm

Progresi në sistemin e prokurimit publik gjatë vitit 2015 ka qenë i kufizuar. Prokurimi i centralizuar ende nuk është plotësisht efektiv, ndërsa prokurimi elektronik momentalisht është në fazën e pilotimit.

Raportet tona individuale të rregullsisë vënë në pah se zbatimi i kornizës ligjore të prokurimit ende nuk është në nivelin e kënaqshëm pasi që janë identifikuar dobësi duke filluar nga planifikimi i prokurimit, aplikimi i kërkesave të prokurimit deri te menaxhimi i kontratave. Raportet e auditimit të performancës kanë vënë në pah se dizajni aktual i kontratave nuk ofron vlerën për para, mos hulumtim i çmimeve të tregut, dallime të mëdha në çmime mes OB-ve të ndryshme për artikuj të njëjtë etj.

Megjithatë ndryshimet dhe plotësimet e vitit 2016 në LPP, siç janë: Publikimi i kuotimeve, kufizimi i sasisë së planifikuar etj., si dhe implementimi i prokurimit elektronik, që momentalisht është në fazën e pilotimit, pritet të sjellë përmirësime në fushën e prokurimit publik. Gjithashtu nënshkrimi i kontratave të centralizuara nga AQP pritet të jap efektet sa i përket arritjes së vlerës për para dhe kursime reale për OB.

4.1 Hyrje

Në vitin 2015 institucionet publike kanë nënshkruar 10,895 kontrata përmes prokurimit në vlerë rreth 402 milion euro. Kjo vlerë vë në pah rëndësinë e një kornize prokurimi të menaxhuar mirë për të siguruar maksimizimin e përfitimeve për taksapaguesit. Korniza aktuale pasqyron:

- Organizata përgjegjëse me rol specifik për funksionalizimin e prokurimit; dhe
- Ligji për prokurim që vendos kërkesa specifike për OB kur ato zhvillojnë prokurime.

Për të zhvilluar më tej proceset ekzistuese, objektivë e Qeverisë ka qenë implementimi efektiv i një sistemi të centralizuar të prokurimit dhe përdorimi i prokurimit elektronik.

4.2 Roli i organizatave përgjegjëse për prokurimin publik

Organizatave përgjegjëse për funksionimin e prokurimit publik janë: Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) dhe Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP).

KRPP është agjenci e pavarur rregullatore dhe përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik.

Departamenti për mbikëqyrje dhe monitorim në kuadër të KRPP gjatë vitit 2015 kishte monitoruar 38 OB sipas planit me gjithsej 285 aktivitete të prokurimit, si dhe 8 aktivitete të prokurimit sipas kërkesës së Autoriteteve Kontraktuese, Operatorëve Ekonomik apo edhe palëve të interesuara. Të gjitha këto monitorime kishin përfshirë mostra të aktiviteteve të prokurimit nga viti 2014. Asnjë monitorim apo mbikëqyrje nuk ishte zhvilluar nga fillimi i një aktiviteti të prokurimit, por ato ishin bërë pas përfundimit të

procedurave. Pra monitorimi është i vonshëm dhe rekomandimet janë kryesisht teknike, rrjedhimisht ndikimi është i vogël.

OSHP, është agjenci e pavarur dhe është përgjegjëse për zbatimin e procedurave dhe shqyrtimin e ankesave në prokurim. Sipas raportit vjetor të punës 2015 OSHP ka pranuar 592 ankesa, prej tyre:

- 25 ankesa apo 4% kanë mbetur pa vendim përfundimtar si pasojë e mungesës së tre (3) anëtareve të bordit;
- 166 raste apo 28 % e totalit të ankesave është aprovuar vendimi i AK;
- 196 raste apo 33 % janë kthyer në rivlerësim;
- 129 raste apo 22% është marr vendim që të anulohen procedurat e prokurimit duke i kthyer në ritenderim;
- 53 raste apo 9% ankesat janë tërhequr nga OE; dhe
- 23 raste apo 4% nuk janë shqyrtuar për arsye të ndryshme siç janë: ankesa jo të kompletuara, mos kompetencë lëndore e OShP etj.

Procesi i shqyrtimit ka vënë në dukje që AK nuk po i zbatojnë plotësisht dispozitat e LPP-së apo legjislacionit sekondar. Shkeljet më të shpeshta janë të ndërlidhura me: neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, neni 7 – barazia në trajtim/jo diskriminimi, neni 10- Mjetet për promovimin e Transparencës, neni 27- Dosja e Tenderit, neni 28- Specifikimet teknike, neni 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, neni 60- Kriteret për Dhënie të Kontratës. Këto shkelje ndikojnë negativisht në arritjen e vlerës për para dhe ofrimin e kushteve të barabarta për OE. Numri i madh i ankesave rezulton me përsëritje të tenderit, vonesa në nënshkrimin e kontratave dhe vonesa në pranimin e benefiteve nga shërbimet apo investimet kapitale.

AQP, vepron në kuadër të Ministrisë së Financave dhe është përgjegjëse për zhvillimin e prokurimeve të përbashkëta për AK, zhvillimin e prokurimeve me kërkesën e AK dhe ndihmon në kryerjen e aktiviteteve të prokurimit për AK.

AQP ka përfunduar me sukses katër (4) aktivitete të prokurimit të centralizuar në vitin 2015; "Furnizim me dru", "Furnizimi me thëngjill "Furnizim me mazut" dhe "Furnizim me pelet". Ndërkohë, katër (4) aktivitete të tjera të prokurimit ; "Furnizim me karburante", "Shërbime të transportit ajror", "Furnizim me Letër" dhe "Furnizim me material zyrtar" janë nënshkruar dhe janë në fazën fillestare të implementimit.

4.3 Vlera për para në prokurim

Duke e njohur rëndësinë e prokurimit ZKA gjatë 2015 ka kryer një raport të auditimit performancës **"Mbi implementimin e kontratës për sistemin e prokurimit elektronik"**. Qëllimi i këtij auditimi ishte të vlerësohet implementimi i një sistemi të ri të TI-së për mbështetjen e proceseve të prokurimit të Qeverisë së Kosovës. Ky sistem ka për qëllim të përmirësojë vendimmarrjen duke siguruar informacion të caktuar, përmirësimin e transparencës, dhe implementimin e efikasitetit në zhvillimin e procedurave të prokurimit. Implementimi i tij është pritur të fillojë në fund të vitit 2015 .

Një pjesë e madhe e sistemit të prokurimit elektronik ende nuk është plotësisht operacional dhe se rezultatet e pritura nuk janë realizuar për shkak të mungesës së kapaciteteve menaxheriale, njerëzore dhe teknike në

agjencitë përgjegjëse qeveritare. Ende nuk janë arritur përfitime nga shpenzimet e bëra për zhvillimin e një softueri për prokurim dhe investimi në harduer të TI dhe kërkohen veprime pro-aktive nga Qeveria për të arritur përfitimet e plota nga prokurimi elektronik në të ardhmen e afërt.

4.4 Çështjet kryesore të rregullsisë në fushën e prokurimit

Raportet individuale të auditimit për vitin 2015 kanë treguar që akoma ka mangësi të përbashkëta në menaxhimin e prokurimit, shumë prej të cilave janë theksuar në raportin vjetor të auditimit për vitin 2014. Shumë nga proceset e aplikuara nga OB nuk janë në pajtim të plotë me kornizën e LPP.

Tabela në vijim paraqet çështjet kryesore të cilat janë hasur në shumicën e institucioneve të nivelit qendror dhe nivelit lokal.

Çështja	Shkaku	Ndikimi	Veprimi që kërkohet
Vonesa në realizimin e projekteve kapitale.	Mungesë e kontrolleve për të siguruar që procedurat e prokurimit kanë filluar me kohë dhe nuk është monitoruar në mënyrë efektive implementimi i kontratës në baza kohore. Mos harmonizimi i kërkesave për rrjedhë të parasë me fondet në dispozicion.	Vonesa në realizimin e përfitimeve nga projekti dhe presioni për buxhetin e viteve vijuese për shkak të kohës së kërkesave për pagesa.	Procedurat e prokurimit të kryera me kohë dhe të mbështetura nga menaxhimi i vazhdueshëm i kërkesave për para kundrejt orarit të pagesave. Aplikimi i penaleve për çdo vonesë.
Mos respektimi i kërkesave të Ligjit për Prokurim Publik.	Dobësitë sistematike të prokurimit kanë ndodhur për shkak të anashkalimit të procedurave të prokurimit dhe udhëzuesve nga zyrtarët kompetent	Favorizime potenciale apo diskriminime ndaj OE-ve. Vlerë e dobët për para dhe/apo dështim për t'i marrë shërbimet e caktuara.	Të aplikohen procese të qarta të llogaridhënies përmes mbikëqyrjes dhe rishikimit. Çdo mos aplikim i procedurave apo udhëzimeve të justifikohet dhe aprovohet formalisht. Të aplikohen masa disiplinuese sipas rastit aty ku procedurat/proceset janë aplikuar në mënyrë jo të drejtë.

Blerje pa procedura të prokurimit, në rastet kur kërkohet të aplikohen procedurat e prokurimit. Shmangia e procedurave të hapura të prokurimit, aplikimi i procedurave me kuotim çmimesh apo me vlerë minimale.	Mungesa e kontrolleve që sigurojnë se janë aplikuar kërkesat për prokurim që i përgjigjen madhësisë së kontratës.	Transparenca dhe konkurrenca e zvogëluar rezultojnë në mos arritje të vlerës për para apo humbje të mundshme financiare.	Si më sipër.
Mungesa e planifikimit efektiv për investimet kapitale.	Mungesa e stafit kompetent për hartimin e projekteve dhe dështimi i menaxhmentit për ndarje të mjeteve për kontraktim të këtij shërbimi.	Mungesa e planifikimit të projekteve potencialisht e zvogëlon cilësinë e punëve dhe vlerën për para.	Për secilin investim kapital, procedurës se prokurimit t'i paraprijë projekti i detajuar.
Mungesa e paramasës dhe parallogarisë.	Mungesa e përgjegjësisë dhe e kontrolleve të mjaftueshme nga nivelet më të larta të kontrollit.	Potencialisht kosto shtesë, sfida buxhetore dhe vonesa në realizimin e kontratave.	Duhet të rritet llogaridhënia e personave përgjegjës qoftë të njësisë kërkuese, zyrtarëve të prokurimit dhe menaxherëve të kontratave.

4.5 Ndryshimet dhe plotësimet në ligjin e prokurimit publik

Kuvendi i Republikës së Kosovës në fillim të vitit 2016 ka aprovuar ndryshimet dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik. Ndryshimet dhe plotësimet kryesore janë si më poshtë:

- Procedurat e prokurimit për agjencitë e pavarura me më pak se 50 punëtorë të cilat i përgjigjen Kuvendit të Kosovës, kryhen nga AQP;
- Kontratat publike mund të ndahen në lote homogjene apo heterogjene;
- Kur Ministria e Financave cakton AQP-në për kryerjen e një aktiviteti të prokurimit personat e autorizuar për përmbylljen ose nënshkrimin e kontratës janë Zyrtari përgjegjës i Prokurimit dhe ZKA-ja i AQP-së;
- Publikimi i njoftimit për kontratë për kuotimet e çmimeve;
- Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë duhet të përcaktohet që në fillim të procesit të prokurimit;
- Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë derivim prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqindë (30%).

Këto ndryshime pritet që të rrisin konkurrencën, të lehtësojnë nënshkrimin e kontratave të centralizuara, të rrisin transparencën, dhe të ketë rritje të vlerës për para me përcaktimin e pragut +/- 30% e cila kërkon që OB-të të bëjnë një parashikim më të saktë nevojave.

4.6 Rekomandimet

Rekomandojmë Qeverinë që të sigurojë se:

- Aktivitetet e prokurimit të cilat janë përmbyllur dhe nënshkruar nga AQP mundësojnë arritjen e përfitimeve nga blerja aktuale e centralizuar dhe aplikimin e një qasje sistematike për të siguruar rritje të planifikuar të kontratave të AQP për vitet e ardhshme;
- Sistemi i prokurimit elektronik të zbatohet plotësisht në praktikë në të gjitha OB;
- Propozimi i anëtarëve të bordit të OSHP të bëhet me kohë në mënyrë që të mos cenohet funksionalizimi i Bordit dhe të shmangen situatat ku ankesat e OE mbesin të pa shqyrtuara.
- Zhvillimet e nevojshme në OB për adresimin e rekomandimeve të AP, të cekura në Kapitullin 3, të vënë theks të veçantë në çështjet e prokurimit dhe me përgjigje të konsoliduar që mbulon adresimin e çështjeve të prokurimit të auditimeve të performancës.

Rekomandojmë Kuvendin që të sigurojë se:

- Monitorimi i aktiviteteve të procesit të prokurimit në KRPP rregullohet për të siguruar identifikimin, parandalimin dhe eliminimin e gabimeve të mundshme nga AK gjatë e jo pas procesit të prokurimit;
- Ka ushtruar ndikimin e vet tek Qeveria për të siguruar që rekomandimet tona për vitin aktual dhe ato paraprake adresohen plotësisht duke vendosur kontrolle efektive gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe duke siguruar vlerën për para.

5 Fushat me rëndësi të veçantë – performanca

Konkluzion i përgjithshëm

Menaxhimi efektiv, strategjik dhe operacional i mbështetur nga një strukturë e përshtatshme ligjore dhe procese efektive të monitorimit është çelësi për të maksimizuar përfitimin e shpenzimeve publike. Kjo siguron cilësi më të mirë të shërbimeve për qytetarët dhe bizneset.

Ka përpjekje nga institucionet për të vendosur organizim të strukturuar në vend, të përcjellë me bazë ligjore, strategji dhe mekanizma implementues e monitorues.

Megjithatë aktualisht ka mungesë të konsistencës ndërmjet legjislacionit, planeve strategjike dhe mekanizmave implementues si dhe mekanizmat monitorues nuk janë zhvilluar. Në fushat e audituara gjatë vitit 2015 kemi identifikuar dobësitë vijuese:

- përgjigje e dobët në rastet e mos përmbushjes së zotimeve në rastin e NSh-ve të privatizuara;
- mungesë e objektivave të qarta në planet komunale në sektorin e bujqësisë, si rrjedhojë ka munguar vendosja e monitorimit efektiv;
- mekanizmat për ofrimin e sigurisë për punëtorët e ndërtimtarisë nuk janë funksionalizuar plotësisht;
- mungesë e implementimit të duhur e Strategjisë për Personat me Aftësi të Kufizuara Fizike;
- implementim i dobët i masave efektive për Eficiencë të Energjisë; dhe
- proces i dobët në planifikim, shpërndarje dhe kthim të teksteve shkollore.

5.1 Hyrje

ZKA, për disa raste, ka ndërmarrë auditime të performancës që të vlerësojë se si janë përdorë paratë publike dhe rezultatet e arritura. Qasja e aplikuar reflekton kornizën e inkorporuar në standardet e INTOSAI, bazuar në 3 E-të:

- **Ekonomia**, minimizimin e kostos së resurseve të përdorura në një aktivitetet, duke marrë parasysh kualitetin e duhur.
- **Efikasiteti**, relacioni ndërmjet outputeve (daljeve) në kuptim të mallrave, shërbimeve, rezultateve dhe resurseve të përdorura për prodhimin e tyre.
- **Efektiviteti**, shkalla e arritjes së objektivave dhe relacioni ndërmjet ndikimit të synuar dhe ndikimit aktual të një aktiviteti.

5.2 Përmbledhja e raporteve specifike

Në këtë kapitull gjeni përmbledhjen e gjashtë auditimeve të performancës. Këto tema janë përzgjedhur për shqyrtim, si rezultat i një procesi të planifikimit të gjerë që përfshinë diskutimet me një sërë akterësh dhe janë konsideruar fusha me rëndësi për vendin dhe për publikun në përgjithësi.

5.2.1 Monitorimi i zotimeve për Ndërmarrjet Shoqërore (NSh) të privatizuara me spinoff special

Qëllimi i privatizimit është rritja e efikasitetit të ndërmarrjeve dhe mënyra e transferimit të pronës shtetërore në pronë private. Në Kosovë nga viti 2005 përmes metodës spin-off special janë privatizuar 26 NSh, ku blerësit kanë detyrime kontraktuese për investime kapitale dhe për punësim. Këto detyrime/zotime duhet të monitorohen nga AKP dhe në rast mos përmbushjes merren masa ndëshkimi deri të kthimi i Ndërmarrjes në pronësi shtetërore-AKP-së.

Nga 26 NSh-të e privatizuara:

- AKP i ka liruar nga zotimet 20 blerës/ndërmarrje të privatizuara;
- 4 janë kthyer në pronësi të AKP-së, për mos përmbushje të zotimeve;
- 2 janë ende nën monitorim.

Ndërsa 9 prej 26 ndërmarrjeve të privatizuara me spin off special, ishin nën hetime në kohën e auditimit. Këto ndërmarrje nuk ishin pjesë e auditimit.

Përmbushja e zotimeve nga blerësit, për investime brenda periudhës së zotuar ishte nën masën 50%. Pas zgjatjes së afatit për përmbushje, investimet u realizuan afërsisht 70% derisa zotimet për punësim kanë arritur deri 96% kundrejt "Marrëveshje Zotimi".

Rastet e mos përmbushjes së zotimeve janë identifikuar nga monitorimi i AKP-së. Mirëpo Bordi i Drejtorëve i AKP-së nuk ka miratuar ndëshkimet për këto raste,. Për më tepër Bordi ka bërë lirim të blerësve edhe kur nuk janë plotësuar zotimet në tërësi.

Përmbushja e zotimeve është në nivel të ultë. Për të arritur objektivat e synuara nga privatizimi i NSh-ve, Bordi i Drejtorëve i AKP-së duhet të menaxhojë me më shumë pro-aktivitet privatizimet me spin off special dhe procesin e privatizimit në tërësi.

5.2.2 Grandet komunale në bujqësi

Spektori i bujqësisë siguron 25% të punësimit të përgjithshëm dhe përbën rreth 12% të BPB-së²³. Komunitat në vazhdimësi mbështesin këtë sektor me grante, të cilat duhet të menaxhohen në mënyrë efektive për të maksimizuar rezultatet nga paratë e shpenzuara. Ne kemi vlerësuar rezultatet e granteve në bujqësi në Komunitat e Gjakovës në vlerë 316,786€ dhe të Fushë Kosovës prej 277,407€, për vitin 2014.

Të dy komunitat kanë dështuar të vendosin objektiva strategjike të qarta për zhvillimin e bujqësisë. Kjo ka vështirësuar zbatimin e objektivave strategjike në objektiva operative.

Kanë munguar indikatorët e performancës, si pasojë është pamundësuar vendosja e bazës për monitorim dhe vlerësim të rezultateve.

Në mungesë të sistemit monitorues nuk kishte raportim cilësor dhe komunitat nuk kanë informata mbi efektet/rezultatet e granteve.

²³ Bruto Produkti i Brendshëm Bruto

Informimi i fermerëve nuk ishte i mirë. Në Gjakovë kriteret e vlerësimit të fermerëve nuk ishin transparente ndërsa në Fushë Kosovë kriteret në konkurse nuk specifikojnë qartë grupin e synuar të fermerëve. Si rrjedhojë, grantet mund të mos arrijnë të grupet/fermerët bartës potencial për zhvillimin e bujqësisë.

Për të siguruar përdorim efektiv të fondeve dhe rezultate, komunat duhet të qartësojnë dhe ndërlidhin objektivat, të aplikojnë kritere të drejta dhe të konsolidojnë sistemin e monitorimit.

5.2.3 Siguria në punë e punonjësve në sektorin e ndërtimtarisë

Sektori i ndërtimit në vitin 2014 ishte punëdhënësi i 4-të më i madh në Kosovë, duke punësuar rreth 39,000 vetë apo 9.5%. Ky sektor përcjellët me pasiguri në punë dhe prinë me rastet e lëndimeve dhe me vdekje të punëtorëve. Në vitin 2014 janë raportuar 63 raste të lëndimeve dhe 9 vdekje, në 2015 janë evidentuar 44 lëndime dhe 8 raste të vdekjeve. Ne kemi verifikuar nëse sistemet e kontrollit të Inspektorit të Punës (IP) janë funksionale/efektive.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka përgatitur draft-planin strategjik/zhvillimor për siguri dhe shëndet në punë, në të cilin janë përcaktuar synimet e IP, por kjo strategji ende nuk është miratuar nga Ministri. IP nuk ka hartuar plan të qartë operativ, vendimet për inspektime janë të rastësishme. Po ashtu IP nuk ka krijuar proces formal të raportimit mbi gjendjen e zbatimit të ligjit. I mungojnë kapacitetet teknike dhe profesionale që ndikojnë në mosrealizimin e inspektimeve të duhura.

Edhe Këshilli Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë, nuk është funksionalizuar ende. Ky është organ këshillëdhënës i Qeverisë i cili propozon, rekomandon dhe harton politika si dhe përcjell gjendjen e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Mekanizmat për siguri dhe shëndet në punë duhet të funksionalizohen me qëllim që të rritet siguria (fizike) në punë për punëtorët e sektorit të ndërtimtarisë.

5.2.4 Qasja për personat me aftësi të kufizuara fizike

Numri i përgjithshëm i Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK) në Kosovë është rreth 150,000 ose 7% e popullsisë. Qasja dhe kushtet e barabarta në aktivitetet e shoqërisë si: arsim, shëndetësi, punë, janë problem për këta persona. Raporti i Progresit për Kosovën i vitit 2015 ka theksuar mungesën e mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara. Andaj kemi verifikuar nëse aktivitetet e qeverisë janë efektive në përmirësimin e kushteve për këta persona.

Strategjia kombëtare për PAK është miratuar nga Qeveria, por zbatohet pak si nga niveli qendror dhe lokal. Dy mekanizmat e nivelit qendrorë përgjegjës për implementimin e saj nuk i kanë të qarta detyrimet dhe përgjegjësitë dhe nuk kanë komunikim me nivelin lokal²⁴.

Shumica e komunave të audituara nuk i kanë identifikuar/vlerësuar nevojat e personave me aftësi të kufizuara dhe nuk i kanë përfshirë në planet operative komunale. Nuk kanë siguruar forma të brendshme apo të jashtme të financimit. Gjatë licencimit të ndërtimeve të reja Drejtoritë për Planifikim Urban nuk kanë marrë parasysh kërkesat që dalin nga korniza ligjore, lidhur me këta persona. Çështja e lejeve të ndërtimit është e ndërlidhur me nivelin lokal dhe qendror (MMPH).

²⁴ Këshillit Kombëtar për Persona me Aftësi të Kufizuara (KKPAK) dhe Komisionit për Monitorim, Raportim dhe Vlerësim (KMRV).

Strategjia për PAK duhet të zbatohet më mirë dhe të shmangen veprimet e rastësishme të pa planifikuara të institucioneve. Të sigurohet financimi i duhur për PAK dhe nevojat e tyre të merren parasysh në rastet e ndërtimeve të reja.

5.2.5 Sistemi për eficiencë të energjisë

Eficienca e Energjisë (EE) nënkupton, të shfrytëzosh më pak energji për të siguruar/kryer të njëjtin shërbim. Parashihet që deri në vitin 2018 kursimi i energjisë të jetë deri 9%, pas realizimit të investimeve/masave për EE. Përmirësimi EE-së në Kosovë mbetet sfidë²⁵.

Korniza ligjore për EE ende nuk është konsoliduar. Plani i Veprimit është i paqartë, ndërsa në planin përcjellës të tij (të dytin afatmesëm) nuk janë përfshirë institucionet kyçe si MSh, MI dhe MMPH²⁶. Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë aktualisht ka mungesë të burimeve financiare dhe njerëzore për të siguruar monitorimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit për EE. Masat për EE mbështeten kryesisht në financime të jashtme, pa koordinim dhe planifikim të mirë. Si rrjedhojë veprimet e institucioneve qeveritare nuk janë të duhura për të përmirësuar EE-në në vend.

Tri komunat e audituara, Planet Komunale për EE i kanë të paqarta dhe jo-specifike. Nuk përmbajnë listë të qarta të masave që duhet të ndërmerren/realizohen. Nuk janë krijuar Zyrat Komunale të Energjisë, numri i zyrtarëve që merren me zbatimin e masave për EE është i kufizuar. Andaj numri i masave të zbatuara është relativisht i ulët.

Rritja e EE ndihmon sistemin energjetik në Kosovë. Për këtë duhet plane të qarta dhe implementim të tyre si dhe koordinim ndërmjet nivelit qendrorë dhe lokal.

5.2.6 Menaxhimi i procesit të pajisjes së nxënësve me tekste shkollore

Qeveria e Kosovës financon në tekste shkollore për rreth 275,000 nxënës. Kosto totale në tri vitet e fundit ishte 22.7 mil./€, 7.5 mil/€ në vit ose rreth 27.5€ për nxënës. Teorikisht shpenzimet për tekste duhet të kenë rënie pasi kërkohet të kthehen në ripërdorim për së paku dy vite. Por ato vazhdojnë të jenë të njëjta. Për vitin shkollor 2015/16 janë planifikuar 4 mil/€ për tekste ndërsa janë shpenzuar 7.5 mil/€. Ne kemi vlerësuar nëse procesi i planifikimit, shpërndarjes, kthimit dhe riciklimit të teksteve është efikas²⁷.

Vonesat në emërimin e Komisioneve për negociim të çmimit dhe shpërndarje të teksteve, kanë sjellë dobësi në planifikim dhe shpërndarje. Për më tepër termat e përdorura në UA 16/2012 kanë sjellë paqartësi/konfuzion në procesin e shpërndarjes së teksteve. Pasi thuhet se tekstet shkollore jepen falas dhe njëkohësisht kërkon që të kthehen për ripërdorim.

Nuk ka analizë për numrin e teksteve të pranuar në fillim të vitit shkollor dhe atyre të kthyera në fund vit. Janë krijuar stoqe të konsiderueshme në Komuna dhe shkolla dhe nuk ka koordinim/komunikim të mirë mes

²⁵ Entitetet e përfshira në këtë auditim janë: Agjencia e Kosovës për Eficientë të Energjisë (AKEE), MZHE, MAP, MAPL, MMPH dhe Komuna e Drenasit, Gjakovës dhe Prizrenit.

²⁶ Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

²⁷ Entitetet e përfshira në këtë auditim janë: MASHT dhe komunat: Prizren, Pejë e Gjakovë.

MASHT dhe DKA²⁸. Si rrjedhojë kthimi i teksteve është i ulët e shpenzimet e larta për porositë e teksteve të reja shkollore.

Riciklimi i librave shkollore është praktikuar nga një numër i vogël i shkollave. Bazuar në dy raste, procesi i riciklimit pritet të sjellë përfitime financiare²⁹. Andaj ky proces mbetet për tu adresuar.

Procesi i shpërndarjes së teksteve shkollore duhet të përmirësohet për të maksimizuar efektin e parave të shpenzuara për këtë çështje. Të eliminohet krijimi i stokeve dhe procesi i kthimit të stimulohet/ngritet.

5.3 Treguesit e Performancës në Komuna

ZKA ka realizuar raporte për performancën financiare dhe jo-financiare në fusha të caktuara të komunave që nga viti 2013. Treguesit e performancës ofrojnë një mundësi për komunat individuale të kenë pikë reference performancën e tyre kundrejt komunave homologe, treguesit e të cilave po përmirësohen për çdo vit.

Fushat kryesore të rishikimit janë investimet kapitale, të hyrat vetjake, financimi nga donatorët, shpenzimet e reprezentacionit, shpenzimet për telefoni mobile dhe derivateve të naftës, kontratat në vepër, detyrimet dhe llogaritë e arkëtueshme, lejet ndërtimore dhe subvencionimi i studentëve. Më shumë detaje janë dhënë në raportin e ZKA-së "Performanca financiare dhe shërbimet e ofruara në komuna në vitin 2015 - Të dhëna krahasuese dhe tregues të performancës".

Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore nga ky projekt janë:

Çështja	Përgjigja e kërkuar
Variacione mes komunave të madhësisë së ngjashme ekzistojnë, por nuk kanë vëmendjen e duhur nga Kryetarët e komunave dhe palët tjerë të interesit për rishikimin e informacioneve të tilla për të nxitur ndryshime pozitive.	Menaxhmenti i Komunës duhet të bëjë krahasime të duhura me komunat tjera, të analizojë të gjeturat e këtij raporti dhe të ndërmarrë masat e duhura për të përmirësuar performancën në fushat ku treguesit demonstrojnë potencial për përmirësim (në momentin që konfirmohet inputi i të dhënave dhe në momentin që bëhet vlerësimi kritik i tyre, për shembull përdorimi i derivateve mund të reflektojë distancën gjeografike të komunës). Palët tjerë të interesit si MAPL dhe Asociacioni i Komunave duhet të mbështesin këtë proces duke përfshirë fokusimin e punës në përmirësimin e cilësisë së të dhënave kur është e nevojshme. Një bazë të dhënash online për TP-të për të siguruar transparencën për TP-të. Përfshirja e TP-ve në Raportet Vjetore.

²⁸ Drejtoria Komunale e Arsimit

²⁹ Përfitimet e përlllogaritura janë minimum rreth 33,000 €/vit, për tërë vendin.

Përgjigja ndaj TP-ve duhet të përshtatet sipas nevojës për çdo komunë, duhet të merren parasysh një sërë çështjesh të përbashkëta nga të gjitha komunat, duke përfshirë shpenzimet e reprezentacionit, drekat zyrtare, shpenzimet e telefonit mobile dhe kontratave për shërbime të veçanta - ku shpenzimi paraqet rrezik për reputacionin e organizatave të sektorit publik - dhe përdorimin e të hyrave vetjake;	Përdorimi i TP-ve për të vendosur standarde/ të nxjerrë në pah praktikatat e mira - të marrë në konsideratë potencialin për të ofruar stimulime (siç zbatohet aktualisht nga DEMOS në fushë të kufizuar të aktiviteteve). Zhvillimi i standardeve të përbashkëta për përdorimin e shpenzimeve të reprezentacionit, etj.
Trajtimi dhe mbledhja e llogarive të arkëtueshme kërkon veprim të veçantë	Rishikim më sistematik i llogarive të arkëtueshme të ndërlidhur me procesin e buxhetit

5.4 Rekomandimet

Rekomandoj Kuvendin e Kosovës që të:

- Kërkojë nga Qeveria të ketë një strategji për të siguruar se performanca e organizatave buxhetore maksimizohet nëpërmjet zbatimit të strukturave të duhura ligjore dhe operative - duke përdorur rezultatet e raporteve të auditimit të performancës për vitin 2015 të AP-së për të nxjerrë në pah fushat e përbashkëta për t'u zhvilluar;
- Kërkojë nga Bordi i AKP-së të demonstrojë qasje proaktive në raport me NSh-të e privatizuara me spin-off special që sjellë vlerë maksimale në gjenerimin e investimeve kapitale dhe mundësive të punësimit;
- Kërkojë nga Qeveria të ketë një strategji e cila demonstroi një qasje të koordinuar për maksimizimin e performancës së komunave dhe njeh rolin e të gjithë akterëve përkatës, përfshirë MAPL, USAID etj.

Rekomandojmë Qeverinë të përfshijë institucionet qendrore dhe lokale për të:

- Siguruar që grandet bujqësore të komunave realizohen në bazë të objektivave të qarta strategjike duke i zbërthyer në aktivitete operative duke aplikuar sisteme të orientuar në rezultate;
- Siguruar se Këshilli Kombëtar për shëndetin dhe sigurinë në punë është plotësisht funksional si dhe për të siguruar miratimin e Strategjisë për Zhvillimin e IP-së;
- Sigurojë zbatimin e strategjisë kombëtare për PAK dhe të kërkojë një raport se si mekanizmat qendrorë, MMPH dhe komunat janë duke adresuar këtë, si në rastet e ndërtimeve të reja;
- Rishikoj kapacitetet e Agjencisë për Eficientë të Energjisë së Kosovës për të harmonizuar aspiratat dhe planet si dhe për të siguruar maksimizimin e burimeve të financimit;
- Sigurojë se MASHT-it rishikon dhe azhurnon UA 16/2012 për sigurimin e teksteve shkollore për nxënësit, për të siguruar vlerën për para në planifikim, shpërndarje dhe kthim të teksteve shkollore.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për “Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit”.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin "Theksim i Çështjes" ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Opinionet e auditimit dhe rekomandimet kryesore

Tabela 1. Opinionet e auditimit dhe rekomandimet kryesore për Institucionet Shtetërore

1.1. Opinionet e pa modifikuara		
Entiteti	Buxheti i rishikuar (në mil.€)	Përmbledhje e Rekomandimeve Kryesore
Ministria e Punëve të Brendshme	112.06	Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatoni procesin e vetëvlerësimit në mënyrë aktive; Siguroni që planifikimi i buxhetit për vitet e ardhshme përfshin pagat e të gjithë punonjësve. Jepni fund praktikës së lidhjes së kontratave pa procedura të prokurimit dhe punësimit pa procedura të rekrutimit; Siguroni që pozitat e mbuluara nga ‘zyrtarë në detyrë’ nuk i tejkalojnë afatet ligjore; Shtoni kontrollet mbi menaxhimin e automjeteve të policisë.
Ministria e Forcave të Sigurisë së Kosovës	45.07	Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; Shqyrtoni arsyet për planifikim të dobët të buxhetit me theks në projektet kapitale; Shtoni kontrollet mbi menaxhimin e kontratave përfshirë ekzekutimin e pagesave.
Ministria e Financave	31.15	Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; Zhvilloni një strategji gjithëpërfshirëse për institucionin.
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	26.40	Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatoni procesin e vetëvlerësimit në mënyrë aktive; Siguroni se është përpiluar një regjistër i rreziqeve dhe plani i veprimit për adresimin e tyre; Siguroni funksionimin e plot të AB; Adresoni dobësitë e kontroleve në fushën e subvencioneve; Klasifikoni drejtë investimet kapitale.
Ministria e Administratës Publike	20.80	Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe menaxhoni procesin e vlerësimit të rrezikut në mënyrë aktive; Aplikoni vlerësimin e dobësive në fusha të identifikuara dhe përpiloni planin për adresimin e tyre; Forconi kontrollet në procedimin e pagesave sipas afateve kohore; Vlerësoni projektet kapitale me nevoja reale para inicimit të procedurave të prokurimit.
Kuvendi i Kosovës	8.64	Siguroni planin e veprimit për menaxhimin e rrezikut; Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së.
Administrata Tatimore	8.15	Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; Siguroni që janë kryer analiza lidhur me shkaqet për diferencat mes të dhënave të ATK-ës dhe Thesarit për rimbursimet; Shtoni efikasitetin në inkasimin e parasë publike.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	5.18	Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatoni procesin e vetëvlerësimit në mënyrë aktive; Përgatitni regjistrin e rrezeve; Vlerësoni dobësitë e identifikuar dhe përpiloni një plan veprimi për adresimin e tyre.
Ministria e Integritetit Evropian	1.66	Siguroni që plani për përpilimin e PVF-ve i adreson të gjitha çështjet lidhur me mos-pajtuueshmëritë me kornizën për raportim; Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatoni procesin e vetëvlerësimit në mënyrë aktive; Siguroni planin e veprimi për menaxhimin e rrezikut; Siguroni që blerjet, përveç në rastet kur nuk parashihet me ligj, janë bërë përmes procedurave për prokurim publik.
Zyra e Presidentit	1.65	Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatoni procesin e vetëvlerësimit në mënyrë aktive; Adresoni dobësitë e kontrolleve mbi procesin e prokurimit .

1.2 Opinione të pa modifikuara me theksim të çështjes

Entiteti	Buxheti i rishikuar (në mil.€)	Arsyeja për theksimin e Çështjes	Përmbledhje e Rekomandimeve Kryesore
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	307.25	Shpalosje e pasaktë e pasurive dhe obligimeve në PVF	Analizoni shkaqet për theksim të çështjes dhe siguroni regjistrim të plotë dhe të saktë të të gjitha pasurive jo-kapitale dhe shpalosje të saktë të të gjitha obligimeve; Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; Adresoni dobësitë e kontrolleve mbi subvencione dhe transfere, prokurim dhe rekrutim.
Ministria e Infrastrukturës	175.50	Për shpenzimet e mirëmbajtjes janë paguar nga kategoria investime kapitale; Mos regjistrimi në regjistrin e pasurive projekteve në bashkëfinancim me Komuna; Mosprezentim i drejtë e pasurive tjera.	Zbatoni proces sistematik të përpilimit të PVF-ve; Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatoni procesin e vetëvlerësimit në mënyrë aktive; Përpiloni planin për menaxhim të rrezikut; Adresoni dobësitë në procesin e prokurimit dhe siguroni klasifikimin e drejtë të shpenzimeve; Regjistroni të gjitha bashkë financimet dhe kapitalizimin e tyre dhe regjistroni saktë pasuritë;
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	55.66	Procesimi i pagesave të subvencioneve është përcjellë me parregullsi (pagesa të dyfishta ndaj përfituesve).	Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatoni procesin e vetëvlerësimit në mënyrë aktive; Adresoni pagesat e parregullta për subvencione; Siguroni planin për menaxhim të rrezikut; Siguroni menaxhim të duhur të të hyrave.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	46.34	Keq klasifikim të shpenzimeve ndërmjet kategorive dhe nënvlerësim të pasurive tek shpalosjet në PVF.	Analizoni dhe adresoni shkaqet për theksim të çështjes; Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatoni procesin e vetëvlerësimit në mënyrë aktive; Funkcionalizoni KA-në; Adresoni dobësitë e kontrolleve mbi proceset e prokurimit, subvencione dhe rekrutim, si dhe mbi kompensimin e stafit akademik.
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	39.09	Keqklasifikimet e projekteve kapitale të ndërtuara për riatdhesim dhe projektet e bashkëfinancuara me komunat, janë regjistruar si pasuri.	Siguroni që plani për përpilimin e PVF-ve 2016 i adreson të gjitha çështjet lidhur me mos-pajtueshmëritë e 2015-ës me kornizën për raportim; Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatoni procesin e vetëvlerësimit në mënyrë aktive; Aplikoni një regjistër të rrezikut dhe planin e veprimit për menaxhimin e tij; Adresoni dobësitë e kontrolleve mbi procesin e prokurimit, rekrutimit dhe ekzekutimit të pagesave; Siguroni që shpenzimet janë regjistruar në kategoritë përkatëse dhe regjistrori pasuritë nëse është dëshmuar se janë në pronësi të OB-ës .
Ministria e Shëndetësisë	37.98	Keq klasifikim i shpenzimeve ndërmjet kategorive dhe nënvlerësim i pasurive tek shpalosjet në PVF.	Analizoni dhe adresoni shkaqet për theksim të çështjes dhe prezantoni informacione të drejta dhe të vërteta në pasqyrat financiare; Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatoni procesin e vetëvlerësimit në mënyrë aktive; Aplikoni një regjistër të rrezikut dhe planin e veprimit për menaxhimin e tij; Adresoni dobësitë e kontrolleve mbi procesin e prokurimit, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe menaxhimin e subvencioneve; Funkcionalizoni modulën e të hyrave në kuadër të Sistemit Informativ Shëndetësor;
Ministria e Drejtësisë	19.11	Në shpalosje të PVF-ve, pasuritë nuk janë plotësisht të sakta dhe të besueshme..	Adresoni i plotësisht rekomandimet e AP dhe AB; Siguroni planin e veprimit për menaxhimin e rrezikut; Vlerësoni shkaqet për nivelin e dobët të ekzekutimit të buxhetit; Aplikoni zhvlerësimin e duhur të pasurisë.

Ministria e Punëve të Jashtme	18.71	Shpenzimet për mallra dhe shërbime të realizuara ishin të pa aprovuara nga vitet paraprake dhe një pjesë e tyre ishin shpenzime të paregjistruara; Pasuri e paprekshme e pa regjistruar në SIMFK	Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatoni procesin e vetëvlerësimit në mënyrë aktive; Aplikoni planin e veprimit për menaxhimin e rrezikut; Siguroni që PVF-ët prezantojnë informata të plota dhe të sakta; Ekzekutoni pagesat për kontrata vetëm pasi që është verifikuar progresi i projektit; Siguroni se nuk ka nënvlerësime/mbivlerësime të shpenzimeve dhe të hyrave si rezultat i lëvizjeve të kursit të këmbimit; Siguroni aplikim të plotë të kriterëve specifike për promovim të zyrtarëve dhe për emërimë në Shërbimet e Jashtme; Siguroni që pasuritë janë regjistruar dhe vlerat e tyre janë raportuar.
Zyra e Kryeministrit	12.17	Keqklasifikimi i investimeve kapitale; mungesa e raportimit nga përfituesit e subvencioneve dhe mos prezantimi i pasurisë së AUV në PVF.	Aplikoni në mënyrë konsistente rregullat për monitorimin e dhënies së subvencioneve dhe siguroni që përfituesit i arsyetojnë shpenzimet në pajtueshmëri me qëllimin e subvencionit; Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatoni procesin e vetëvlerësimit në mënyrë aktive; Adresoni dobësitë e kontrolleve mbi procesin e prokurimit, klasifikimin e investimeve kapitale dhe raportimin e pasurisë.
Doganat	8.63	Mos shpalosja e plotë e Llogarive të Arkëtueshme në PVF dhe nënvlerësimi i zhvlerësimit të pasurive.	Analizoni dhe adresoni shkaqet për Theksim të çështjes dhe përpiloni një plan veprimi për ti adresuar ato; Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatoni procesin e vetëvlerësimit në mënyrë aktive; Siguroni azhurnimin e TARIK; Shtoni kontrollet rreth përcaktimit të vlerës së importeve që të minimizohet parashtrimi i ankesave nga subjektet ankimore; Adresoni dobësitë e kontrolleve mbi procesin e prokurimit, procesimin e pagesave dhe menaxhimin e burimeve njerëzore.
Ministria për Kthim dhe Komunitete	8.32	Keq klasifikim i shpenzimeve dhe nënvlerësim i pasurive	Analizoni dhe adresoni shkaqet për theksim të çështjes dhe përpiloni një plan veprimi për ti adresuar ato; Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatoni procesin e vetëvlerësimit në mënyrë aktive; Siguroni regjistrim dhe raportim të qartë dhe të plotë të pasurisë; Siguroni përmes Komitetit të Auditimit përmirësim të cilësisë së raporteve të NJAB-ës; Zbatoni raportim të rregullt të obligimeve në MF.

Ministria e Diasporës	1.57	Mos prezantim i saktë i vlerës së pasurive jo financiare dhe stoqeve në shpalosjet e PVF- e.	Siguroi aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatoni procesin e vetëvlerësimit në mënyrë aktive; Siguroi planin e veprimit për menaxhimin e rrezikut; Siguro që të gjitha blerjet apo shërbimet të kontraktohen në pajtim me kërkesat e LPP-së; Siguroi që subvencionet janë dhënë në pajtim me kriteret e përcaktuar a dhe shtoni kontrollet rreth monitorimit të tyre; Siguroi raportim të saktë dhe të plotë të pasurive.
-----------------------	------	--	---

1.3 Opinioni i kualifikuar

Entiteti	Buxheti (në mil.€)	Arsyeja për kualifikimin e opinionit/theksimin e çështjes	Përmbledhje e Rekomandimeve Kryesore
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	4.49	Regjistri i pasurive kapitale i mbivlerësuar nga pasuria e Komunave; Zhvlerësimi jo i saktë i pasurisë.	Analizoni dhe adresoni shkaqet për kualifikimin e opinionit dhe theksim të çështjes dhe identifikoni veprimet e nevojshme për të siguruar prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurisë; Siguroi aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së ; Aplikoni vlerësim të detajuar në lidhje me nivelin e ekzekutimit të buxhetit dhe adresoni dobësitë e kontroleve mbi prokurimin dhe fushat tjera të shpenzimeve.

1.4 Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Entiteti	Buxheti (në mil.€)	Arsyeja për kualifikimin e opinionit/theksimin e çështjes	Përmbledhje e Rekomandimeve Kryesore
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	22.44	Keqklasifikimi i shpenzimeve nëpër kategori ekonomike; Mosprezentimi i saktë i pasurive financiare dhe jo financiare në PVF.	Siguroni prezantim të drejtë dhe të vërtetë të shpenzimeve dhe pasurisë në PVF; Siguroni që plani për përpilimin e PVF-ve i adreson të gjitha çështjet lidhur me mos-pajtuueshmëritë me kornizën për raportim; Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; Zbatoni një plan veprimi për menaxhim të rreziqeve; Adresoni dobësitë e kontrolleve mbi prokurim; Siguroni që përfituesit e subvencioneve janë të paguhur në pajtim me rregullat për dhënien e subvencioneve dhe që paratë e shpenzuara të monitorohen.

Tabela 2. Opinionet e Auditimit dhe rekomandimet kryesore për Komuna

2.1. Opinion i pa modifikuar			
Entiteti	Buxheti (në mil.€)	Përmbledhje e Rekomandimeve Kryesore	
Lipjan	12,40	Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatoni procesin e vetëvlerësimit në mënyrë aktive; Përmirësoni llogaridhënien dhe raportimin menaxherial; Analizoni dhe adresoni dobësitë e kontrolleve mbi prokurim dhe mbi fushat e tjera të shpenzimeve; Monitoroni performancën buxhetore në mënyrë më rigoroze si dhe identifikoni dhe adresoni pengesat për ekzekutimin e buxhetit në nivelet e planifikuara.	

2.2. Opinionet e pa modifikuara me theksim të çështjes

Entiteti	Buxheti (në mil.€)	Arsyeja për theksimin e çështjes	Përmbledhje e Rekomandimeve Kryesore
Prishtina	62.11	Pagesa në bazë të memorandumave për bashkëfinancime në llogari të donatorëve/ implementuesve në mungesë të raportit të progresit fizik dhe financiar të projekteve. Mos regjistrimi i plotë pasurive në SIMFK; investimet kapitale dhe mallrat dhe shërbimet ishin keq klasifikuar; dhe një pjesë e shpalosjeve në PVF nuk ishin të sakta.	Analizoni mangësitë në procesin e regjistrimit të pasurisë, arsyet për keq klasifikim të shpenzimeve dhe formën e pagesave për bashkëfinancime; Siguroni një plan sistematik për përpilimin të PVF duke përfshirë edhe shpalosjet; Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatoni procesin e vetëvlerësimit në mënyrë aktive; Përmirësoni llogaridhënien dhe raportimin menaxherial; Analizoni dobësitë e kontrolleve mbi prokurim dhe ndërmerrni veprimet e nevojshme për ti adresuar ato.
Prizren	39.37	Keq klasifikime nga investimet kapitale në mallra dhe shërbime; Mos prezantimin e vlerës së plotë të pasurive.	Siguroni regjistrimin e saktë të pasurive kapitale; Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatoni procesin e vetëvlerësimit në mënyrë aktive; Përmirësoni llogaridhënien dhe raportimin menaxherial; Analizoni dhe adresoni mangësitë në kontrollet mbi prokurim.
Ferizaj	25.25	Keq klasifikimi i investimeve kapitale në lidhje me shërbimet e kujdesit shëndetësor shtëpiak të financuar nga Komuna dhe mos regjistrimi i pasurisë së blerë.	Analizoni arsyet për Theksimin e Çështjes dhe përpiloni një plan veprimi për të mundësuar një prezantim të drejtë të investimeve kapitale dhe pasurisë në PVF; Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatoni procesin e vetëvlerësimit në mënyrë aktive; Përmirësoni llogaridhënien dhe raportimin menaxherial; Siguroni mbikëqyrje më efektive mbi ekzekutimin e buxhetit, regjistrimin e shpenzimeve në kode adekuate dhe shmangni aneks kontratat; Siguroni zbatimin e plotë të rregullave të prokurimit dhe në rastet e bashkëfinancimit pagesat të bëhen vetëm pasi janë ofruar shërbimet; Siguroni mbledhjen e qirave të pa arkëtuara; Regjistroni të gjitha pronat e Komunës.

Gjilan	21.84	Regjistri jo i plotë dhe i pasaktë i pasurive; Pagesa para së të pranohen shërbimet dhe në pajtim me marrëveshjen.	Siguroni regjistrimin e plotë të pasurive kapitale; Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatoni procesin e vetëvlerësimit në mënyrë aktive; Përmirësoni aranzhimet e llogaridhënies dhe cilësinë e raportimit menaxherial; Analizoni dhe adresoni dobësitë e kontrolleve mbi prokurim.
Peja	21.13	Keqklasifikime nga kategoria e Investimeve kapitale në mallra dhe shërbime dhe subvencione; Mos regjistrimi plot i pasurisë në SIMFK	Klasifikoni saktë shpenzimet dhe regjistroni saktë pasuritë kapitale; Siguroni aplikimin e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatoni procesin e vetëvlerësimit në mënyrë aktive; Përmirësoni aranzhimet e llogaridhënies dhe cilësinë e raportimit menaxherial; Analizoni dhe adresoni dobësitë e kontrolleve mbi prokurim.
